



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:093799

Datë: 27.08.2021

Numri i dokumentit: 02121582

**PS.nr.27/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL**, Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja Violeta Namani-Hajra me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shpresa Sahiti, në çështjen penale të kundër të pandehurve B.A, H.H, A.H,V.SH, S.P, M.K, XH.B, N.SH, S.B ,I.B, S.H, SH.L, E.C , J.G, B.R, J.L dhe A.H të dyshuar secili veç e veç për veprën penale Shpëlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPRK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta“, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096”, Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit “ në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPRK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, gjykata jashtë seancës me datë **22.07.2021**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHEN** si të bazuara kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve si dhe të pandehurit B.A av. K.K, H.H av. A.B, A.H av.R.K, V.SH av.H.H, S.P av. T.ZH, M.K av. F.U, XH.B, N.SH av.S.M, S.B av. A.M, I.B, SH.L, E.C av. T.C, J.G av. I.D, B.R, J.L av. M.R dhe A.H.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, PPS. nr.54/14, e datës 24.10.2016, **dhe pushon procedura penale** për të pandehurve: B.A, H.H, A.H,V.SH, S.P, M.K, XH.B, N.SH, S.B, I.B, SH.L, E.C, J.G, B.R, J.L dhe A.H.

Të pandehurit se secili veç e veç kishin për të kryer veprën penale Shpëlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPRK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta“, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096”, Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të

terrorizmit “, në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPrK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013.

Pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme, të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen .

**ANULOHET** pjesërisht Urdhëresa lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, PPR.KR.222/2014, e datë 26.04.2016, me të cilën janë sekuestruar përkohësisht paluajtshmëritë si më poshtë, dhe është urdhëruar ndalimi i tjetërsimit të këtyre paluajtshmërive apo objekteve ndërtime, si dhe çdo ndryshim në librat kadastral, dhe atë për ngastrat që janë objekti i kësaj çështje penale si në vijim :

- Ngastra kadastrale nr....., .....-Prishtinë, kompania “ .....”, e përfaqësuar nga S.B,
- Ngastra kadastrale nr....., .....-Prishtinë, I.B,
- Ngastra kadastrale nr....., .....-Prishtinë, E.C,
- Ngastra kadastrale nr....., .....-Prishtinë, B.R,
- Ngastra kadastrale nr.....2, .....-Prishtinë, SH.L, J.L dhe A.H,
- Ngastra kadastrale nr....., ..... Graçanicë, N.SH,
- Ngastra kadastrale nr....., ..... Graçanicë, S.P,
- Ngastra kadastrale nr....., ..... Graçanicë, A.H,
- Ngastra kadastrale nr....., ..... Graçanicë, H.H,
- Ngastra kadastrale nr....., ..... Graçanicë, H.H,

Dhe, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, titullarve të këtyre paluajtshmërive - pronarëve iu lejohet disponimi me të gjitha autorizimet që burojnë nga të drejtat pronësore për këto ngastra kadastrale.

Palët e dëmtuara: familja P....., familja N....., Agjencia e Privatizimi të Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, kundër të pandehurve B.A, H.H, A.H,V.SH, S.P, M.K, XH.B, N.SH, S.B,I.B, S.H, SH.L, E.C, J.G , B.R, J.L, dhe A.H të dyshuar secili veç e veç për veprën penale Shpëlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta “, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096”, Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit “ në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013.

Sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.27/19, të datës 31.05.2021, për të pandehurin S.H dhe për propozim të sekuestrimit të pasurisë të ndjerit D.S konform nenit 36 par.1 të KPPRK-së, me pajtimin e palëve në procedurë veçohet procedura, me qëllim të efikasitetit të procedurës në këtë çështje penale.

Kjo gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin fillestarë me datë 31.05.2021, në të cilin shqyrtim të pandehurit B.A, H.H, A.H,V.SH, S.P, M.K, XH.B, N.SH, S.B, I.B, S.H, SH.L, E.C, J.G, B.R, J.L, A.H nuk e pranuan fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, ashtu që të pandehurit dhe mbrojtësi e tyre janë udhëzuar se kanë të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e shqyrtimit fillestar të paraqesin kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, andaj gjykata seancën e shqyrtimit të dytë është caktuar dhe është mbajtur me datë 06.07.2021, paletë në procedurë kanë elaboruar kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, ndërsa prokuroria e prokurorisë speciale ka dhënë përgjigjeje në kundërshtime e mbrojtësve dhe të pandehurve.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit B.A, av.K.K ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 25.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri B.A, pasi që konform neni 250 të KPPRK-së par 1, pika 1. 1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale, dhe pika 1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë, pasi që sipas përshkrimi faktik të dispozitivit të aktakuzës thuhet se i njëjti akuzohet se, në Prishtinë në datat e përmendura me poshtë duke e ditur apo duke pasur arsye të dija se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitetet kriminale posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek persona të etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar nën pikën 1 të Aktakuzës, si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruara në pikat 1 deri në 19,në bashkëpunim me të paraqiturit si përfaqësues të shitësit të parcelës së tokës dhe vet blerësit që është vetë ai, ai ka transferuar dhe ka tentuar që të transferoj pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës burimit, sistemimit, lëvizjes dhe pronësisë së pronave apo në çfarëdo rrethanash me qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangeje nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore për veprime e tyre, ku me datë 24 maj 2006, ka përvetësuar parcelën e tokës nr..... dhe nr....., në ....., nga E.G i cili kishte vepruar në cilësi të përfaqësuesit dhe në emër të anëtareve të familjes Steviç, në çmim artificial të ulëte prej 82.000euro (20.83 euro për m2), dhe me datë 18 tetor 2006, ai ka transferuar parcelat e tokës nr..... dhe nr..... në Lapje Selo, te H.H në çmim artificial të ulëte prej 80.000euro (20.29 euro për m2). Prokurori ka cekur se duke ditur ose duke pasur arsye për të ditur, është e qartë se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, çështja kryesor për të vërtetuar është dashja direkte e të pandehurit, se a e ka ditur i njëjti që këtë parcele burojnë nga një aktivitet kriminal, e në rastin konkret i pandehuri nuk i kishte konvertuar apo transferuar pronat, por të njëjta prona i ka përvetësuar me mirëbesim të plot dhe në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, në këtë aktakuzë askund nuk përshkruhen veprimet konkret i të mbrojturit tim, se ai tentoj ta transferoj pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës burimit, sistemimit, lëvizjes, po ashtu nuk përmende as një rrethanë e vetme se i mbrojturi im kishte për qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale, I mbrojturi imë nuk kishte miqësi, as lidhje në biznes me anëtarin e grupit, nuk i ka njohur dhe nuk ishte i përfshirë në blerje false, pasi që historikun e bartjes së pronësisë është se me datë 20.04.2006 , S.H- ish drejtor i zyrës kadastrale ka lëshuar një vendim mbi aprovimin e përmbarimit të aktgjykimit P.nr.2880/09,dhe ka bërë ndërrimin e pronësisë të ngastrave 1513/1,1507/1,1506/1,1514/1,dhe 1515/1, në Qagllavic në emër të n.s, po ashtu ditën e njëjtën ai i lëshoj edhe dy vendime tjera dhe aprovoi transferimin e pronësisë së ngastrave .....,1874/3, ....., dhe 258/4 , në Llapnasellë, ngastra 24 në Preoc në emër të , me çka këto vendime janë krejtësisht të pa ligjshme, ndërsa i mbrojturi imë parcelat nr..... dhe nr..... në Lapje Selo, i ka blerë, është e pa mundur se i njëjti ishte në dijeni ose kishte arsye për të ditur se para 30 ditësh të njëjta parcela janë regjistruar në mënyra të

kundërligjshme në zyrën e kadastrit, në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 05 shtator 2006, ka deklaruar se e ka blerë token sepse kishte nevojë për veprimtarin e biznesi të tij dhe se menaxheret nga VW Grup, i kërkuan atij që të gjejë një lokacion përskej magjistrales Prishtinë-Shkup, me pas i njëjti e ka shitur këtë toka pas katër muaj për një çmim më të ulët se çmimi që e ka blerë, arsyeja e shitjes së tokës ka qenë se toka nuk ishte e përshtatshme për biznesi të tij, e gjithë kjo nga blerja deri te shitja është e pa logjikshme në aspektin financiar dhe është një tregues i fuqishëm i aktiviteteve të shpëlarjes së parasë, po ashtu nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se i njëjti nuk kishte burim financiare për blerjen e tokës, nga prova e bashkangjitur në kërkesë pasqyrojnë fitimi NTP “ ..... “, do të vërtetohet se fitimi ishte shumë më i madhe se 790 euro, po ashtu kërkon nga gjykata që të shpallen prova të pa papranueshëm marrja në pyetje e të pandehurit E.G me datë 22 .08.2016, pasi që e njëjta deklaratë është marrë në cilësi të pandehurit, ndërsa tani është propozuar në cilësi të dëshmitarit ku në të njëjtën cilësi nuk është marr asnjë herë në pyetje si dhe deklaratat e të pandehurit të dhen në procedurë paraprake si në polici dhe në prokurori nuk mundë të përdoret si provë për arsye se i njëjti është marrë në pyetje duke u njoftua me të drejtat në cilësi të dëshmitarit, në bazë të gjithave të lartcekurve kërkon nga gjykata që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale kundër të pandehurit B.A, ngase nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzë.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit H.H av. A.B ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 15.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS.nr.54/2014, e datës 24.10.2016, ndaj të mbrojturit të tij H.H për shkak se provat janë thelbësisht të pambështetura dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i akuzuari H.H e ka kryer veprën penale Shpëlarje e parave në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi prej 1 janari 2013, në kundërshtim me nenin 10(2) të rregullores së UNMIK-ut nr.2004/2 për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përafërta po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit nr.03/L-196 parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në fuqi që prej 30 shtator 2010, po ashtu e parapër edhe me nenin 56(1) të Ligjit Nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në fuqi prej 15 qershorit 2016, siç referohet me nenin 308 të kodit të ri Penal të republikës së Kosovës në fuqi që prej 1 janar 2013, në kundërshtim me nenin 32 par 2. nën par.2.1, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit mbi parandalimin e spastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010. Në kundërshtimin e tij thekson se kjo aktakuzë është e paqëndrueshme për arsye se përshtkrimi faktik për të akuzuarin prej 1-17 është i njëjtë, më pak ose aspak ndryshime është në të gjitha pikat prej 1-17 duke i akuzuar për një njësi të veçanta kadastrale, provat në raport me të akuzuarin H.H janë thelbësisht të pambështetshme dhe se nuk ka prova që e mbështesin dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale që pretendohet me aktakuzën PPS.Nr.54/2014, andaj veprimet inkriminuese të cilat prokuroria i drejton ndaj te mbrojturit tim se gjëja se H.H duke e ditur ose duke pasur arsye për të ditur se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale, posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek personat të etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar në pikën 1 të akuzës si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruar nga 1 deri në 17, në bashkëpunim me shitësin e pretenduar të parcelës së tokës ai ka transferuar dhe ka tentuar të transferojë pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës burimit sistemimit, lëvizjes së pronësisë së pronave apo në çfarëdo rrethanash me qëllim të asistimit të pandehurve të tjerë të cilët ishin të përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore për veprimet e tyre në veçanti me 18 tetor 2006 ai ka transferuar parcelën e tokës nr..... dhe ....., në Lagjen ..... nga H.A me çmimin artificialisht të ulët prej 80.000 euro (20.29 euro për m2). Te gjitha

parashkrimet si më lartë në raport me të pandehurin H.H për objekt kanë dy parcela të paluajtëshmëris ..... dhe ....., e të cilat pasi kanë qenë pronë shoqërore, e të cilat qenkan falsifikuar dhe mandej qenkan transferuar nga një person në tjetrin. Mirëpo arsyetimi i Aktakuzë prej 165 faqe dhe provat materiale kanë të bëjnë me një grup tjetër, që paskan kryer vepra të ndërduarshme, nga falsifikimi, mashtrimi, shpëlarje të parave e të ndërlidhura me krimin e organizuar. Me aktakuzën e kundërshtuar pretendohet se i akuzuari H.H, parcelat ..... dhe ....., i ka blerë nën çmimin e tregut si dhe duke e ditur ose duke pas parasysh për të ditur se të njëjtat paskan qenë pronë shoqërore, janë fitim të krijuar me aktivitetet kriminale. I mbrojturi imë H.H, për t'i blerë atë paluajtëshmëri paraprakisht ka konsultuar avokatin për tu siguruar lidhur me statusin e atyre paluajtëshmërive dhe tek pas marrjes së përgjegjjes së avokatit se nuk ka kurrfarë pengesash, i njëjti avokati i ka përpiluar kontratën e shitblerjes, e kanë vërtetuar në gjykatë dhe më pastaj e kanë regjistruar në Kadastër në emër të tij. Përveç kësaj i njëjti po konsiderohet se e ka blerë nën çmimin e tregut sipas një ekspertize dhe athua ky ekspert me cilat kritere e ka vlerësuar çmimin e tregut kur dihet se vet AKPPM tani AKP, pronat shoqërore paluajtëshmërit si ngastrat kadastrale ..... dhe ....., me kulturë "tokë bujqësore", janë shitur edhe për 2 euro m2, ndërsa H.H paluajtëshmërit e ka blerë prej 29,29 euro për m2, apo krahasuar me çmimin e shitjes nga AKPPM, është 15 herë ma i madh, po ashtu H.H nuk është njohur me asnjë të akuzuar në grupin tjetër, që arsyetimi i kësaj aktakuze është vetëm e vetëm në drejtim të veprimit të atij grupi dhe gjithashtu as me të akuzuarit tjerë në këtë aktakuzë, përjashtoj B.An nga i cili e ka blerë paluajtëshmërin ku si çdo qytetar dhe me mirëbesim e ka blerë paluajtëshmërin, e ka paguar dhe kurrë nuk është gjetur ndonjë veprim kriminal, të gjitha veprimet e H.Ht që ndërlidhen me blerjen e 2 ngastrave kadastrale në shumë prej 80.000.00 euro, e që sipas aktakuzës e inkriminon atë në veprën penale Shpëlarje e parave është e paqëndrueshme në aspekt ligjor, moral dhe njerëzor, ndonëse H.H në këtë rast është 2 herë viktimë, një herë nga organet shtetërore, kur gjykata i'a ka vërtetuar kontratën e shitblerjes dhe kadastrit i'a ka regjistruar paluajtëshmërin e blerë, e tani prokuroria e akuzon për Shpëlarje të parave dhe propozim konfiskimin e paluajtëshmëris. Prokuroria duke mos gjetur asnjë lidhje dhe veprim të pandehurit Haki me të akuzuarit e të ashtuquajtur Toka 1, tani e akuzon H.Hn për Shpëlarje të parave me një selektim mbase non sens, për faktin se në arsyetim të aktakuzës thotë se disa nuk i ka akuzuar se ka vlerësuar, në një numër të kufizuar të rasteve sidoqoftë rrethanat e shitjes tregojnë se blerësi mund të jetë një blerës në mirëbesim dhe prandaj këta blerës nuk janë të akuzuar për shpëlarje të parave. Në vlerësimin e mirëbesimit të mundshëm të blerësit vlera e tregut të pronës nuk është rrethana e vetme që është marrë parasysh, andaj konsiderojmë se i mbrojturi imë ka qenë blerës me mirëbesim dhe i njëjti duhet të trajtohet vetëm palë e dëmtuar, në bazë të kësaj që thamë më lartë konsiderojmë se kërkesa jonë është e bazuar dhe e njëjta të aprovet nga gjykata konform nenit 250 par 1 nën par 1.4 të KPPRK-së.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit A.H, av.R.K ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 15.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri A.H, pasi që aktakuza është e pa kuptueshme, konfuze e pa bazuar në ligj, jo cilësore dhe profesionalisht e pa arsyetuar, në fakt cilat janë provat të cilat i propozon PPS-ja, e që paraqesin dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari A.H ka kryer këtë vepër penale, dihet se dyshimi i bazuar mirë konforme nenit 19 par.1.12 të KPPRK-së, nënkupton ngritjen e aktakuzës dhe posedimin e provave të pranueshme që do ta bindë një vëzhgues objektiv që një vepër penale që ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri duhet të dihet se qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është pengimi i shpëlarjes së parave për mes tyre bëhet financimi i terrorizmit, pasi që ky ligj thotë se : Shpëlarja e parasë çdo veprim me synim maskimin e origjinës së parasë ose pronës tjetër të fituar me ndonjë vepër penale ku përfshihen: konvertimi ose transferi i parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal, fsheja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendit, lëvizjes,

rregullimit të drejtave ose pronësisë në lidhje me parat ose pronën tjetër të fituara nga aktivitetet kriminale. Ndërsa neni 56 e specifikon se çka është shpëlarja e parave : kush do që duke ditur ose që ka arsyeje për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me kapitullin e IX të KPPRK-së , pasi që nga provat dhe nga arsyetimi i akuzës nuk del kjo që thotë akuza, pasi që i akuzuari A.H nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet kriminal që pretendohet në këtë akuzë, pasi që nga provat e numëruara në aktakuzë nuk është bërë përcaktimi se cili apo cilat fakte pretendohet te vërtetohen e që kanë të bëjnë me elementet qenësore të veprës penale, pasi që kjo veprë penale mundë të kryhet vetëm me dashje, e nga provat e propozuara rezultojn vetëm fajësia e të akuzuarit në kryerjen e aktivitetit të ligjshëm në territorin e Kosovës, e ku fare nuk është bërë cenimi i çfar do vlere të mbrojtur shoqërore, me cilën provë mundë të vërtetohet se i akuzuari parat me të cilat ka paguar çmimin për parcelën që e ka ble nga shitësi F.G kanë buruar nga aktiviteti kriminal, pasi që i mbrojturi im në atë kohë nuk e ka ditur me çka është marr shitësi F.G, këtë rrethanë në atë kohë nuk i kanë ditur as organet e ndjekjes, me çka i mbrojturi im nuk mundë të përgjigjet për aktivitetin e shitësit, pasi që i mbrojturi im parcelën prej 1770 m2, e ka blerë me çmim që i është përgjigjur vlerës reale, e jo me çmimin artificialisht siç thotë aktakuza, parat e çmimit i akuzuari shitësit ia ka paguar për mes xhirollogarisë bankare nëpërmjet bankës, po të ishin këto para të fituara nga aktiviteti kriminal sigurisht që pagesa nuk mundë të behet në këtë mënyrë, sipas nenit 96 dhe 97 i KPPRK-së, përcakton qartë kushtet dhe mënyrën e konfiskimit të dobisë pasurore, par. 2 i nenit 97 të qartë thotë: dobia pasurore mundë ti konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompenzim ose me kompenzim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale, pra i mbrojturi im nuk e ka ditur as nuk ka mundur ta dijë se si shitësi e ka fituar këtë pronë, kjo nuk ka qenë as detyra e tij, mbi këto fakte propozojmë që aktakuza ndaj të mbrojturit tim të hudhet si e pa bazuar në prova dhe ligj.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit V.SH av.H.H ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 05.07.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, për vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri V.SH ,pasi që aktakuza është në kundërshtim me neni 241 par 1 pika 1.5 të KPPRK-së, pasi që neni 241 është përcaktuar qartë se çfarë duhet të përmbaj aktakuza si në nën parag 1.4.dhe 1.7 të KPPRK-së, pika 1.4. kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të

nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale, 1,7 Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore, aktakuzë nuk përshkruhet sipas pikës 1.4, nuk është përfshirë as koha, vendi, objekti dhe mjeti me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale, se çfarë mënyre i mbrojturi im e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, aktakuza nuk është hartuar në përputhje me dispozitat tjera të KPPRK-së, nuk i ka qartësuar elemente e veprës penale, figurën e veprës penale, nuk e ka bërë përshkrimin e saktë të veprime të pandehurit, se si i njëjti i ka fshehur apo i ka maskuar natyrën apo burimin e pasurisë, pasi që përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës ceket se në Prishtinë në datat e përmendura me poshtë duke e ditur apo duke pasur arsye te dijë se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek persona të etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar nën pikën 1 të Aktakuzës deri në 19 , si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruara në pikat 1 deri në 19, ky përshkrim nuk është i

qartë, nuk mund të kuptohet se cili grup kriminal, por kemi të bëj dyshimi për kryerjen e veprës penale Shpërlarje e parasë, gjithashtu nuk është e kuptueshme përshkrimi “ nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruara në pikat 1 deri në 19”, pasi që i mbrojturi imë përmes provave të paraqitura ka dëshmuar se gjithë procesi i shitblerjes së pronës e ka kryer në mënyrë krejtësisht të ligjshme dhe pa ndonjë qëllim të pretenduar nga prokuroria , të njëjtën parcelë të tokës me numër 1877/19, e ka blerë nga pronarja e më parshme K.B nga Llapllaseva, përmes përfaqësuesit të saj SH.S, me çmimin prej 127.400 euro, (25 euro m2), me qëllim që të njëjtën ta shfrytëzoj si një pikë grumbulluese për skrap metalik, të njëjtën prone e ka vërtetuar në organet kompetente për vërtetimin e kontratës pran Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr.6457/07, të datës 18.07.2007, ndërsa i njëjti e ka gjete një pronë me të madhe me më të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së lartcekur, të njëjtën pronën e lartcekur ja ka shitur S.P me çmimin prej 153.000 euro, (30 euro m2), gjatë të gjithë këtij procesi i mbrojturi imë nuk ka pas qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës burimit, sistemimit, lëvizjes dhe pronësisë së pronave apo në çfarëdo rrethanash me qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale ashtu siç pretendon prokuroria, po ashtu nuk qëndron pretendim “se i njëjti ka ditur apo ka pasur arsye se i njëjti ta dinte se parcela e tokës lartcekur është fitim i krijuar me aktivitete kriminale”, ku i njëjti fare nuk ka ditur apo ka qenë i thirru që ta di për ekzistimin e një fakti të tillë , pasi që nuk kuptohet se si ishte në dije se prona që e ka blerë është pronë shoqërore për deri sa e njëjta ishte e regjistruar në emrin e një personi fizik në regjistrin e palujshmëris, po ashtu mjetet me të cila e ka blerë parcelën janë si rezultat i punës së bërë në kompaninë “Riciklimi”, po ashtu i ka kryer të gjitha detyrime tatimore, andaj ne vlerësojmë se rregulli ekonomik i Kosovës është bazuar në konkurrencën e lirë të tregut, nuk është përcaktuar ndonjë çmim fikse për shitblerjen e palujshmerive , atëherë palët kontraktuese mundë ti rregullojnë marrëdhëniet e tyre kontraktuese dhe ti vendosin çmimet me vullnetin e tyre për shitblerje të cilat ata i kanë kryer, po ashtu Ligji 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrime neni 2 përcakton „2.1 pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimeve janë të lirë, që me pajtim të dispozitav urdhëruse të rendit publik dhe të dokeve të mira ti rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre dhe 2.2, Pjesëmarrësit mund ti rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është e paraparë me ligj përderisa nuk rezulton dika tjetër nga dispozitat e këtij ligji apo kuptimi dhe qëllimi i tyre, kjo dispozit sqaron qartë se palët janë plotësisht të lira në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pa ndonjë kufizim, andaj nga të lartcekurat propozon që te hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale kundër të pandehurit V.SH, ngase nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzë.

Në afatin ligjor mbrojtësja e të pandehurit S.P av. T.ZH, ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 28.06.2021, ku propozon që në kuptim të nenit 253 par. 1 pika 1.1 dhe pika 1.4 të KPPK-së , të merrni Aktvendimin me të cilin do ta hudhni aktakuzën dhe do ta pushoni procedurën penale ndaj të akuzuarit S.P, pasi që konsiderojmë se aktakuza e tillë është parashtruar duke u nisur nga rrethanat gjenerale, duke e përfshi edhe të mbrojturin tim gjoja se i njëjti ka kryer veprime inkriminuese, e kjo pa pasur një dyshim të mbështetshëm e të bazuar mirë , por krahas personave të tjerë të akuzuar është ngrit aktakuza edhe ndaj të pandehurit në fjalë, organi i akuzës ka dështuar të bëjë paraprakisht vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga i pandehuri pa mbështetje në asnjë provë të vetme, pasi që provat e cekura në këtë akt akuzues janë të papranueshme nga ana jonë , andaj e kundërshtojmë të njëjtën. Se nuk ekziston asnjë rrethanë fakt apo provë fajësuese për të pandehurin e sipër cekur është fakt i pamohueshëm, kjo mbi bazën se të gjitha veprimet e të mbrojturit tim janë ndërmarrë brenda suazave ligjore dhe se i njëjti nuk ka mundur të dijë e as që ka qenë i detyruar të dij që prapa një kontrate të shitblerjes fshihet ndonjë qëllim tjetër apo veprim i kundërligjshëm, i njëjti duke përfillë tërsisht dispozitat ligjore në fuqi në atë kohë të cilat kanë përcaktuar mënyrën e

bartjes të të drejtës së pronësisë me datë 18.09.2007, ka lidhur kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë me shitësin V.SH nga Skenderaj, i njëjti si pronar dhe shfrytëzues i vetëm i pronës, ku lëndë e kësaj kontrate ka qenë shitja e palujtshmërisë e cila gjendet në Prishtinë, Zona Kadastrale Llapllasellë në vendin e quajtur “ ..”, e që evidentohet sipas numrit të certifikatës UL -71914042-00731, ngastra kadastrale P-71914042-0..... , në sipërfaqe prej 0.50.96 ha , ku palët kontraktuese janë pajtuar për çmimin e shitblerjes të jetë në shumë prej 153.000 euro, dhe i njëjti çmim është paguar në tërësi gjë që vërtetohet me dëftesat e pagesave të lëshuara nga Pro Credit Bank, me rastrin e lidhjes së kësaj kontrate u vërtetua në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me shenjen VR.nr. 8391/2007, e datës 18.09.2007, kanë ekzistuar të gjitha parakushtet ligjore për bartjen e të drejtës së pronësisë tek blerësi, këtu i pandehuri për të njëjtën kontratë asnjëherë nuk është kontestuar për vlefshmërinë dhe pasojat juridike që prodhon dhe se paraqet tërësishtë mënyrën legjitime të marrjes së të drejtës së pronësisë mbi pronën në fjalë, ndërsa sa i përket çmimit kontraktues ,, tek një raport juridiko-detyrues civil palët sipas pranimit të disponibilitetit me vullnetin e tyre të lirë e caktojnë lëndën, çmimin dhe mënyrën e kryerjes së një pune juridike, ashtu ka ndodhur edhe në rastin konkret ku shitësi e ka caktuar çmimin ndërsa blerësi e ka pranuar si të tillë duke lidhë kontratë mes vete, andaj pretendimi i Prokurorisë se çmimi i blerjes është fiktiv është pretendim që bien dhe nuk duhet të merret parasysh fare nga Gjykata ngase me të gjitha provat e tjera u vërtetua se blerja e pronës, bartja e të drejtës së pronësisë dhe rrjedhimisht shfrytëzimi i pronës është bërë brenda kornizave ligjore dhe nuk përmban veprime inkriminuese, ashtu që ekziston edhe transaksioni bankar, andaj konsiderojmë se e gjithë kjo që u tha më lartë rezulton se aktakuza fare nuk ka të bëjë me asnjë përkrahim, provë apo dëshmi për ndonjë veprim konkret kundërligjor të marrë nga i mbrojturi im, i cili është përmbajtur nga çdo veprim që do ta inkriminonte në veprën penale që i vihet në barrë pasi që aktakuza nuk ka fare mbështetje ligjore, në bazë të lartcekurave kërkojmë nga gjykata që aktakuza ndaj të mbrojturit tim të hudhet poshtë.

Në afatin ligjor mbrojtësja e të pandehurit M.K av. F.U ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 08.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS.nr.54/2014, e datës 24.10.2016, ndaj të mbrojturit tim, pasi që bazuar në historikun e stories se gjendjes faktike u vërteta se i pandehuri nuk e ka ndërmarr asnjë veprim inkriminues dhe as që e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, por e gjitha është një jo e vërtet dhe nuk qëndron, por e gjitha është se i njëjti është mashtruar dhe vënë nën lajthitje nga ana e shitësit SH.S, të cilit i mbrojturi im para se të lidhe kontrate të shitblerjes si objekt lëndor, i ka kërkuar dokument si provë në mënyrë që të vërtetohet fakti se prona si objekt lëndor a është e ngarkuar me ndonjë ngarkesë të çfardo lloji, dhe shitësi SH.S pa hezitim i ka prezantuar dokumentacion të rreme, siç po shihet në këtë rast përkatësisht në këtë çështje penale, i mbrojturi i im në prezantim të dokumentacionit nga ana e shitësit prap i ka vërtetuar në Drejtorin Kadastrale në Graçanice ku edhe aty pa kurrfarë problemi ia bartin pronësinë me status të pronarit të parcelës të blere në fjalë, i mbrojturi im obligimin për shitblerje e ka kryer përmes bankës, e qe do te thotë parcelën në fjalë e ka blere duke ju nënshtruar procedurës se rregullt institucionale e jo siç pretendohet nga prokuroria speciale se gjeja ky veprim i tij është kryer për shpëlarje të parave, çka e tera është një jo e vërtet dhe nuk qëndron një pretendim i tillë, por e gjitha është se i mbrojturi im është viktimë dhe i dëmtuari si materialisht poashtu dhe moralisht, i cili që ne fillim përkatësisht që nga dita e pare prej se ka kuptuar se është një çështje inkriminuese thekson se me ma pas fal nuk e kisha blerë e jo më të blesh me para e të akuzohesh e te sillesh neper gjykate ne këtë moshë. I mbrojturi im pas gjashte vite parcelën në fjalë ia shet një firme me emrin “Jusaj Metal”, e cila gjithashtu para se me lidh kontrate e njëjta firme në mënyrë të detajuar interesohet se mos kjo paluajtshmeri ka ndonjë të mete apo ngarkesë, gjë që një fakt i tillë vërtetohet dhe pastaj me datë 16.03.2013, e lidh kontratën me të mbrojturin tim, e cila procedure ka shkuar gjithashtu me veprimet procedurale të rregullta si në gjykate, në bankë ashtu dhe edhe në



Drejtorin Kadastrale ku dhe i bëhet bartja e paluajtshmeris pa asnjë problem, i mbrojturi im me SH.S si shitës i parcelës në fjalë asnjëherë nuk ka pasur shoqëri apo dhe ta ketë njohur personalisht, por e gjitha është se ata e ka njohur përmes një personi i cili i ka treguar se është një person ka aludu në Shaban Sylen qe shet toka dhe me këtë rast nuk është e vërtet dhe nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorisë speciale se ka bashkëpunuar me të dhe propozojmë gjykatës që mos t’ja fale besimin këtij pretendimi, i mbrojturi i ka ndërmarr veprimet juridike të rregulla dhe para se të lidh kontratën e shitblerjes, ka verifikuar dokumentacionin dhe pastaj ka ndërmarr veprimet, kjo mundë të vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës siç janë kontrata e vërtetuar ne Gjykatë, pagesa për paluajtshmerin në fjalë si objekt lëndor në këtë rast është bërë përmes bankës si dhe bartja e pronësisë në Drejtorin Kadastrale, andaj e kundërshton këtë aktakuzë si të pabazë e në veçanti kualifikimin juridik për veprën penale për të mbrojturin tim nga fakti se asnjë mënyrë apo aspekt nuk është provuar me ndonjë bazë faktike e as ligjore se ka kryer veprën penale që i vie në barrë, ndërsa në seancën e shqyrtimi të dytë ka deklaruar se dua të lidhem në pikën 3 të kontratës së shitblerjes me nr. 1877/2, në sipërfaqe prej 0.5471 KH, me flet poseduese 701, pranë zyrës Kadastrale në Llapnaselle – Graçaniçë, dhe fokusohem me pikën 3. thekson „se shitësi deklaroi se kjo patundshmëri nuk është e ngarkuar me kurrfarë barre, hipotekë dhe në rast të lajmërimit të tyre shitësi obligohet ta heqë me shpenzimet e veta , në rastin konkret i mbrojturi im që në fillim është interesuar se kjo provë a ka të meta , anomalia e llojit të vetë në këtë rast është se e njëjta kontratë është vërtetuar me veprime juridike institucionale përkatësisht në Gjykatën me kompetencë ish Komunale, njëkohësisht bazuar prap me këtë kontratë ku pretendimet e Prokurorisë Speciale janë se duke ju referuar nenin 2. të kontratës ku parashihet shitblerja e 156.750 euro, për të cilin çmim konsiderojmë se është real nga vetë fakti se gjatë shitblerjes i mbrojturi im në cilësinë e blerësit është interesuar se pari se si dhe sa janë çmimet dhe ka konsideruar se është një çmim i përfshirë edhe në vlerën e rrethit shoqëror, mbi këto fakte të thëna më lart i propozojmë gjykatës që aktakuza ndaj të mbrojturit tim të hudhet si e pa bazuar.

Në afatin ligjor i pandehuri XH.B ka bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, që është dorëzuar në gjykatë me datë 25.06.2021, i njëjti kërkon nga Gjykata që të hudhet aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, dhe ta pushon procedurën penale ndaj meje për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se unë e kam kryer veprën penale si në aktakuzë, pasi që të gjitha pretendimet në aktakuzë në raport me mua e që për objekt ka parcelën e paluajtshmerisë 1877/1, pronë shoqërore e cila qenka falsifikuar dhe mandej qenka transferuar nga një person në tjetrin është e pavërtetë, se gjoja unë në bashkim dhe në vazhdim, e në bashkëkryerje me një grup tjetër e paskam kryer vepra të ndryshme nga falsifikimi, mashtrimi , shpëlarja të parave e të ndërlidhura me krimin e organizuar ose paskemi ditë për ato aktivitete kriminale, ndërsa këtë nuk e paskan ditur organet shtetërore si gjykata dhe organet tjera si Drejtoria e Kadastrit të Prishtinës., me pas thekson se Parcela 1877/1, gjoja e kam blerë nën çmimin e tregut si dhe duke e ditur ose duke pas parasysh për të ditur se e njëjta paska qenë pronë shoqërore dhe është fitim i krijuar me aktivitete kriminale, unë këtë tokë në mënyrë të rregullt e kam blerë, e që do të thotë se organet kompetentë përkatësisht kontratën e kam vërtetuar në gjykatë dhe të njëjtën e kam regjistruar në kadastër, por unë si laik e dije se çmimi i tregut është i lirë dhe varësisht situatës edhe çmimet ndryshojnë, ashtu që për kohën kur e kam blerë por edhe kur e kam shitur atë tokë çmim ka qenë real, unë nuk e kam njohur shitësin, por përmes përfaqësuesit të tij SH.S e kam blerë tokën dhe në asnjë mënyrë nuk më ka shkuar mendja se prona nuk është në rregull, se përndryshe në asnjë variantë nuk e kisha blerë dhe më pastaj me e shitur, të gjitha veprimet e mija në asnjë mënyrë nuk kanë të bëjnë me veprën penale që ndërlidhet me blerjen e 1 ngastre kadastrale në shumën prej 51.700 euro, dhe të shitur me pastaj për çmim prej 51,855 euro , sepse as nuk e kam ditur dhe as nuk kam mundë ta dijë se prona

paska pas të meta, pra në këtë rast unë jam vetëm e vetëm viktimë, andaj veprimet eventuale kriminale të personave tjerë në një aktakuzë krejt tjetër e të cilët as nuk i kam njohur nuk mundë të më mveshen mua, sepse unë pronën e kam blerë duke i besuar përfaqësuesit të shitësit, e që kjo është e njëjtë sikur shumë të tjerë që prokurori i përmendë në aktakuzë se pronën e kanë blerë me mirëbesim dhe për atë arsye ndaj tyre nuk ka ngritur aktakuzë .

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit N.SH av.S.M ka dorëzuar kërkesë për hudsonje të aktakuzës, të dorëzuar në gjykatë me datë 05.07.2021, ku në kërkesën e tij për hudsonje të aktakuzës konsideron se vepra penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i tij nuk përbënë elemente të veprës penale dhe nga përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës nuk shihen elementet qenësore të kësaj vepre penale dhe se në të njëjtën nuk shihen veprimet e të akuzuarit se çka ka ndërmar ai në kryerjen e kësaj vepre penale, i njëjti fare nuk ka ditur dhe nuk ka pasur as mundësi, e arsye se parcela e tokës nr.1877/1, në Lapnaselo, është fitim i krijuar me aktivitete kriminale, i njëjti jeton në Prizren, paluajtëshmëria gjendet në ....., Komuna e Prishtinës, i akuzuari fare nuk e njeh shitësin e as të akuzuarit tjerë në aktakuzë, për deri sa në muajin Mars të vitin 2008, duke u kthyer me babin e tij nga Prishtina për në Prizren, me veture në skaj të rrugës e vëren një tabelë ne një are duke shkrujatur “*Toka në Shitje*” dhe një numër i telefonit, ndalet e merr numrin e telefonit dhe tani kontakton me të akuzuarin XH.B, me të cilin për here të parë takohet në Prishtinë dhe bisedon rreth shitblerjes të paluajtëshmëris në fjalë, i njëjti ia tregon listën poseduese të akuzuarit Nadir lidhur me paluajtëshmërit në fjalë e cila tani është objekt i akuzës, i tregon se toka është e tij dhe nuk ka kurrfarë problemi, ku me pastaj shkojnë në Kadastrin e Prishtinës, e vërtetojnë faktin se parcela në fjalë është e të akuzuarit XH.Bt, është në emrin e tij dhe nuk ka kurrfarë pengese, e arrijnë çmimin e shitblerjes në shumën prej 51.855 euro, të cilën shumë përmes bankës i akuzuari N.SH ia ka paguar të akuzuarit Xhevahir, pastaj e përpilojnë kontratën e shitblerjes e paluajtëshmëris, të cilën kontratë e vërtetojnë në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr.nr.1550/2008, të datës 06.03.2008, dhe me anë të kësaj kontrate toka bartet në emër të akuzuarit N.SH. I akuzuari Nadir i ka besuar të akuzuarit Xhevahir, dokumentin zyrtar ka qene në emër të akuzuarit Xhevahir, i akuzuari Nadir nuk ka ditur e as qe ka mundur të dijë për historikun e kësaj parcele, kush ka qenë pronar i mëhershëm para të akuzuarit Xhevahir, si ka ardhur ai në pronësi, të gjitha këto e përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit ,i njëjti as që ka ditur e as që ka mundur të dijë prejardhjen e paluajtëshmërive, pasi që asnjë të akuzuar nuk i njeh, nuk i ka kontaktuar asnjëherë ata, ai me profesion është kasap dhe ushtron veprimtarin në Prizren dhe Prishtinë, me blerjen e paluajtëshmëris ka patur ndërmend të ndërtoj një thertore, i njëjti të hollat për blerjen e kësaj parcele ka paguar në mënyrën legale dhe nuk ka pasur qëllim ti msheh apo të përfshihet në kryerjen e veprës penale, andaj aktakuza e prokurorisë nuk ka asnjë mbështetje në ndonjë prove materiale ajo bazohet në supozimet dhe hynë ne mendjen e të akuzuarit se ai ka qenë dashtë ta dijë që kjo ngastër është e përfshirë me aktivitet kriminal, andaj propozoj që aktakuza ndaj të mbrojturit tim të hudhet poshtë si e pabazuar dhe argumentuar.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit S.B, av.A.M ka dorëzuar kërkesë për hudsonje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 22.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri S.B, pasi që në arsyetim të aktakuzës nuk përshkruhet asnjë provë e artikulueshme në të cilën do të mundë të mbështetej pretendimi i PSRK-së. Nuk ka asnjë provë më të cilën i mbrojturi im të këtë ditur apo të ketë mundur të dijë të dijë për arsye se blerja e pronës nga i njëjti është duke u bazuar në dokumentet publike, të lëshuara nga organet kompetente publike dhe atë, më datë 25.04.2012, Komuna e Prishtinës – ka lëshuar certifikatën e pronës për parcelën ....., ..... në emër të shitëses SH.M, pa asnjë vërejtje sipas numrit të lëndës 011-953-2332/2012. Më datë 18.06.2012, Komuna e Prishtinës ka lëshuar shkresën e titulluar “Informimi nga Plani Rregullues

me nr ref:05-350-21709, lidhur me planin rregullues për lokacionin ku bën pjesë edhe parcela ..... Më datë 02.07.2012, Gjykata Komunale në Prishtinë – ka vërtetuar Kontratën e datës 29.06.2012, të lidhur në mes SH.Mt dhe “ ..... “ SHPK e përfaqësuar nga i mbrojturi im S.B pa asnjë vërejtje sipas numrit Vr.nr.2394/2012. Nga të gjitha këto prova nuk mund të tentohet të kalohet përgjegjësia tek i mbrojturi im pa u përfshirë zyrtarët e Gjykatës të cilët nuk kanë pa asnjë element të dyshimtë në shitblerjen e lartcekur, si zyrtarët e Gjykatës ashtu edhe të Zyrës Kadastrale të Komunës së Prishtinës kanë pasur njohuri profesionale dhe faktike më të mëdha se i mbrojturi im si për parcelën kadastrale ....., si për parcelat tjera, si për çmimet e kohës që kanë qarkulluar, si për procedurat ligjore për realizimin e shitblerjes të kësaj parcele andaj në rast se të njëjtit kanë vlerësuar se kjo shitblerje ka qenë në rregull, si objekt i kontratës prejardhja e tij ashtu edhe çmimet paguese për të njëjtën, kurse të njëjtit nuk janë pjesë e kësaj aktakuze atëherë si mund të jetë i mbrojturi im i cili ka ndërmarrë veprime juridike duke u mbështetur në të dhënat e dokumenteve publike, i mbrojturi im parcelën e ka blerë për shumën prej 150.000.00, më datë 29.06.2012, kurse kredia është marrë nga i njëjti në shumën prej 300.000.00, paraprkisht me datë 02.01.2012, rreth 6 muaj para blerjes së parcelës kadastrale, kredia ishte marrë për investim pikërisht për blerjen e kësaj parcele dhe ndërtim të objektit afaristo banesor në të, kurse pagesat janë kryer nga mjetet e marra nga kredia pas lidhjes së kontratës i mbrojturi im si përfaqësues i ‘ .....’ SH.P.K pagoi çmimin dhe atë: me datë 04.07.2012, i pagoi shumën prej 40.000.00 në emër të pagimit të çmimit për objektin e kontratës Vr.nr.2394/2012, e datës 02.07.2012. Me datë 05.07.2012, pagoi shumën prej 40,000,00, në emër të pagimit të çmimit për objektin e kontratës Vr.nr.2394/2012, e datës 02.07.2012. Me datë 10.07.2012, pagoi shumën prej 35.000.00, në emër të pagimit të çmimit për objektin e kontratës Vr.nr. 2394/2012, e datës 02.07.2012, Me datë 12.07.2012, pagoi shumën prej 35.000.00 në emër të pagimit të çmimit për objektin e kontratës Vr.nr. 2394/2012, e datës 02.07.2012, të njëjta prova i bashkëngjiten kërkesës, po ashtu ka potencuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1045/2018, i datës 29.10.2018, pasi që për të gjitha shitblerjet, janë lidhur kontratat formale të noterizuara të dëshmuara me transaksionet bankare, nuk ka pas asnjë ndalesë apo pengesë ligjore për shitblerjen e këtyre pronave, të njëjtat janë regjistruar në regjistrat kadastral tutje cituar “Gjykata vlerëson se nuk është detyrë e blerësve për ta vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pronës ngase kjo vërtetohet përmes institucioneve relevante të sistemit juridik të një shteti dhe atë në radhë të parë duke filluar nga të dhënat kadastrale ku janë regjistruar pronaret e paluajtëshmërive dhe këto regjistra janë regjistra publik, quhen publik pikërisht për faktin se të gjithë qytetarët që kanë interes për ta ditur se kujt i përket paluajtëshmërija, kanë qasje në këto regjistra dhe mundë ta dijen se kush është pronarë dhe vetëm ekzistimi i këtij fakti është i mjaftueshëm për të mos dyshuar që prona buron nga krimi, kjo për faktin se regjistrimi në librat kadastral i paraprijnë një sër veprimesh tjera të cilat duhet ndërmarr konform dispozitave ligjore për të ardhur deri tek veprimi final e që ekzistimi i të gjitha këtyre rrethanave të lartcekura objektivisht e përjashton dijeninë e palës me interes juridik se në ato paluajtëshmëri ka diç kontestuese a kundërligjore, andaj duke u mbështetur ne provat e bashkangjitura dhe praktiken gjyqësore i propozon gjykatës që e njëjta ta aprovon këtë kërkesë dhe ta hudh aktakuzën PPS.nr.54/2014, e ushtruar me datë 25.10.2016, dhe ta pushoj procedurën penale ndaj te mbrojturit të tij S.B.

Në afatin ligjor i pandehuri I.B ka bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave që është dorëzuar në gjykatë me datë 24.06.2021, duke kundërshtuar provat për arsye se provat nuk u siguruan në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose subjektet tjera shtetërore, si dhe provat shkelin rregullin e kapitullit XVI të Kodit Penal, ka një arsye të artikulushme që gjykata ti gjej provat thellësisht të pa mbështetshme, andaj zbulimi i provave nga prokurori i shtetit në aktakuzën e paraqitur kundër të pandehurit I.B me gjithë sqarimin e

arsyetimin e dhënë është i pa qartë, kontradiktor dhe i pa sistemuar, kështu që këtë aktakuzë e bëjnë të pabazuar dhe të pa mbështetshme në prova të qëndrueshme e të pranueshme juridikisht. Po ashtu, prokuroria nuk ia ka bashkangjitur shkresave të lëndës ndonjë provë konkrete që do të rezultonte me krijimin e dyshimit se i akuzuari Buza ka mund të jetë në dijeni se patundshmëria objekt i shitblerjes sipas kontratës në muaj qershor të vitit 2012, patundshmëria në Zonën Kadastrale të Prishtinës, njësia kadastrale P-71914059-0....., lloji i pronës private zonë rurale, lloji i shfrytëzimit bujqësor se kjo paluajtëshmëri nga z Sherif Salihu të jenë fituar në mënyrë të kundërligjshme, në këto rrethana I.B as që ka mund të ishte në dijeni sepse vërtetimi i kësaj kontrate i është nënshtruar kontrollit strikt nga institucionet e sistemit të drejtësisë, duke filluar nga administrata shtetërore përmes të dhënave kadastrale, vërtetimit të kësaj kontrate tek noteri kompetent, pasi që Sherif Salihu ishte një ish partner i tij i biznesit, në qershor të vitit 2012, i ofroi tokën në këmbim në emër të borxhit që kishte në raport me mua. meqenëse unë isha aso kohe shumë i zënë për shkak të udhëtimeve biznese edhe jashtë vendit, kam autorizuar lidhur me këtë çështje vëllai tim B.....in përkatësisht nënën time N.B që të veproj në emrin tim. Vlera e tokës ishte 150.000 euro, ndërsa në emër të borxhit dhe çmimit shitblerës i kam paguar 75.000 euro, SH.S, pas zbritjes së borxhit, të cilat i kishte marr nga një kushëri në Gjermani dhe se kam marrë një kredi në bankë prej 15.000 euro për pjesën tjetër, këto shuma i kam paguar Sherifit sepse i kam besuar SH.S dhe se nuk e kam ditur se kjo pagesë duhet të bëhet përmes llogarive bankare, por kjo situatë ishte e lidhur edhe me detyrimet financiare që Sherifit i kishte zonjës E.U, dhe në emër të kryerjes së borxheve reciproke kjo ishte mundësia e vetme e imja që të sigurohem që Sherifi t'i fshinte borxhet ndaj meje. Ne vlerësojmë se prokuroria në mbështetje të akuzës nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të bërë të besueshëm dyshimin e bazuar mirë se këmbyesit përkatësisht shitblerësit e patundshmërive, objekt i akuzave në rastin konkret i pandehuri I.B të ketë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës, të kem ditur apo ka mundur të isha në dijeni se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral, fleta poseduese në emër të E.U apo kudo tjetër, po ashtu ne piken 10 në dispozitivin e aktakuzës, pretendimeve të prokurorisë nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë konkrete që do të vërtetohet dyshimin për akuzat në ngarkim timin, duke mos përshkruar rrethanat se si, kur, me çfarë mjetesh ka ndihmuar, në ç'mënyre i ka ndihmuar shitësit dhe blerësit, cili ishte motivi për të ndihmuar njëjtë, të gjitha këto dilema e bëjnë të pa mundur një dyshim të bazuar të kryerjes së veprave penale nga unë i akuzuari I.B, andaj i propozon gjykatës që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale kundër tij, ngase nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzë.

Në afatin ligjor i pandehuri SH.Lka bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave që është dorëzuar në gjykatë me datë 28.06.2021, konsideron se vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbënë elemente të veprës penale, konkretisht në këtë kërkesë i kundërshton provat lidhur me rastin Vujoviç, përshkruan historikun e blerjes së parcelës, fillimisht e ka bërë verifikimin e parcelës, mandej të njëjtën e ka blerë se bashku me dajën e tij D.A, sipas marrëveshjes çmimi i dakorduar për 15.40 ari, ishte 200.000 euro apo 12.987 euro ari, ku 50% e vlerës do të paguhej nga ne (100.000 euro), ndërsa 100.000 euro, do të paguaj daja im Dukagjin Asllani. Pretendimet e Prokurorisë se ne ishim në dijeni për dallaveret me këto prona pasi që sipas prokurorisë ne i kishim dokumentet e tokës nuk qëndron, të gjithë dinë se çdo blerës ka të drejtë të paraqes kërkesën në Komunën e Prishtinës, dhe pas pagesës së taksës merr komplet historikun e parcelës, po të mos kishim vepruar në këtë mënyrë mund të kishte hamendje në historikun e kësaj toke, në historik kemi vërejtur se kjo tokë është hetuar nga Prokuroria në Prishtinë dhe nga Policia e Kosovës, në të dyja këto institucione kam shkruar personalisht dhe jam interesuar, më kanë thënë se toka është hetuar, dhe as nga policia dhe as nga prokuroria nuk është gjetur asgjë e dyshimtë, ku kërkesës së tij i ka bashkangjitur këto prova të cilat gjinden edhe në shkresat e lëndës dhe kërkon nga gjykata që të hudhet poshtë kjo aktakuzë sepse

ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë nga përgjegjësia penale dhe se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar.

Në afatin ligjor mbrojtësja e të pandehurit E.C av. T.C ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 06.0.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, ndaj të mbrojturit tim, pasi që përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës ceket se në Prishtinë në datat e përmendura me poshtë duke e ditur apo duke pasur arsye të dijë se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek persona të etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar nën pikën 1 të Aktakuzës si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruara në pikat 1 deri në 19, në bashkëpunim me siç pretendohet shitësin dhe blerësin e parcelës së tokës, ai ka transferuar dhe ka tentuar të transferoj pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, sistemit, lëvizjes dhe pronësisë së pronave apo në çfarëdo rrethanash me qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin të përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore, për veprimet e tyre në veçanti. Me datë 24 gusht 2012, ai ka përvetësuar parcelën e tokës nr. 1870/11, nga I.S, në çmim artificialisht të ulet prej 9.900 € (2.48 Euro për m<sup>2</sup>), si dhe me qëllim të shmangies së obligimeve për raportin sipas nenit 17(2.2) të Ligjit 03L-196. Me datë 16 nëntor 2012, ai ka përvetësuar parcelën e tokës nr. 1870 në ..... nga SH.L në çmim artificialisht të ulet prej 61.000€, (39,61€ m<sup>2</sup>). Me datë 17 maj 2015, ai ka transferuar parcelën e tokës nr. 1870/22 në ..... tek J.L dhe A.H në çmim artificialisht të ulet prej 72,000€, (46.75 € për m<sup>2</sup>). Në pjesën e dytë të arsyetimit të këtij rasti përkatësisht kronologjinë e arsyetuar dhe përmbledhjen e rasteve nën paragrafin 126 është konstatuar se i mbrojturi im ka fituar dy parcelat e tokës në ....., përmes dy shitjeve të ndryshme. E para nuk ka .....11, ishte fituar nga I.S, çmimi i deklaruar në kontratë është 9,900 €, vetëm nën kufirin e epërm të themeluar në bazë të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, sipas ekspertëve, në vitin 2011, vlerat e tregut të kësaj parcele ka qenë më shumë se 400.000€. Nuk ka pagesa, është gjurmuar për këtë shitje, sjellja e tij është e lidhur plotësisht për veprimet e pastrimit të parave dhe qëllime, i mbrojturi im u intervistua me 27 Korrik 2016 dhe deklaroi se ai u mor vetëm me SH.S, me të cilin më parë kishte pasur një marrëveshje të pasurive të patundshme e cila shkaktoi një shumë të trazirave dhe konflikteve. Në paragrafin 127 është konstatuar se parcela e dytë transferuar tek E.C ka nr. ....2, dhe kjo nuk është e bashkangjitur në ngastrën nr. ...., për të shkuar nga parcela 1870 -22, tek parcela ..... është e nevojshme të kalohet parcela nr. ....21, e cila u përket njerëzve të tjerë, blerja e këtyre dy pronave nuk është ekonomikisht e justifikueshme. Përkatësisht nën paragrafin 131 thuhet se një herë një grup i organizuar kriminal ishte në gjendje që në mënyrë kriminale të merrte pronësinë e tokës në emrin e familjeve serbe përmes mjeteve kriminale ata i kanë transferuar pronat tek individët tjerë duke i përdorur autorizimet që ishin falsifikuar, trilluar apo marrë në mënyrë mashtruese dhe sipas paragrafit 132 këto operacione të transferimit të pronave pa dyshim që janë operacione të shpëlarjes së parave. Prokuror i PSRK-së, mori Aktvendim për zgjerimin e hetimit për të përfshirë 32 (tredhjet e dy) të pandehurve, ndër të cilët edhe të mbrojturin tim E.C, në urdhëresat e kontrollimit për të gjithë të pandehurit, që përfshinë bastisjen kundër njërit nga të pandehurit kryesorë SH.S që është kryer brenda objekteve të Burgut të Dubravës i janë konfiskuar disa dokumente të ndryshme si dhe autorizimi i datës 06 gushtë 2012, lëshuar nga I.S në favor të E.C për të vepruar në emër të lidhur me parcelën e tokës 1970-11, në ....., ky autorizim i vërtetuar nga noteri, asnjëherë nuk është zbatuar sepse shkurtimisht pas kësaj me datë 24. Gushtë 2012, I.S ia ka shitur këtë parcelë (4.000 m<sup>2</sup>), E.C për çmim prej 2.48 €, për m<sup>2</sup>. Më vonë me datë 25 qershor 2013, E.C ka blerë po ashtu parcelën nr. ....2, e cila kishte vlerën krejtësisht të njëjtte të tregut për m<sup>2</sup>, për çmim prej 39.61 €, për m<sup>2</sup>. Kjo tregon se

E.C ka qen i përfshirë në veprimet e pastrimit të parave dhe se ai sikurse personat tjerë të përfshirë në këto shitje e ka ditur apo ka pasur arsyeje të qarta për të ditur se transferet e pronave janë bërë për qëllime të pastrimit të parave. Lidhur me të mbrojturin tim nën par. 246 rezulton se disa dokumente janë konfiskuar nga ana e tij, vlen të përmendet se ai ka poseduar disa dokumente të cilat tregojnë se si e tërë parcela e tokës nr. 1870, është kontestuar, ka pasur vendimin e Zyrës Kadastrale të datës 02 dhjet 2011, i cili ka pezulluar kërkesën e I.S për transferim e pronës sepse është caktuar një masë sigurie – ndalesë, dokumentin e lëshuar nga Prokuroria Komunale të datës 15 dhjet 2010, dhe raportin Policor të datës 05 Nëntor 2010, se policia e Kosovës, “nuk kanë mundur të gjejnë falsifikimin e dokumenteve të përmendura, madje nëse ka pasur vepra penale e përmendur më lartë është parashkruar“, të njëjtat janë përdorur nga disa të pandehur për të demonstruar se ata kanë qenë në mirëbesim, andaj përshkrimi i ngjarjes bazuar në Aktakuzë lë shumë hapësirë dhe mundësi për të dyshuar ngase në asnjë rrethanë nuk u sqarua çështja thelbësore të cilës tani duhet ti qasemi konkretisht, duke iu referuar përshkrimit faktik të Aktakuzës perkitazi me dispozitën e nenit 241 sipas pikës 1.4,1.5,1.6 dhe 1.7 të KPPRK-së, konsideroj se Prokurori nuk e ka kryer detyrimin ligjor me rastin e përshkrimit faktik të veprimeve për të mbrojturin tim ngase sipas pikës 1.4, nuk është përfshirë as koha, vendi, objekti dhe mjeti me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale, nga e tërë kjo që parashtrova më lartë kërkoj nga Gjykata Themelore në Prishtinë, konformë nenit 253 par. 1 nën par. 1.4 të KPPK-së, ta hudhë aktakuzën ndaj të mbrojturit tim E.C.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit J.G, av. I.D ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, të dorëzuar në gjykatë me datë 15.06.2021, sipas të cilës zbulimi i provave të mbledhura gjatë procedurës paraprake nga ana e Prokurorisë në aktakuzën e paraqitur kundër të pandehurit J.G me gjithë sqarimin në arsyetimin e dhënë është i pa qartë, kontradiktor dhe i pa sistemuar, për këtë kundërshtimi duhet të pranohet pasi që provat e propozuar në aktakuzë nuk janë të një vlere provuese ngase nuk i referohen rrethanave apo fakteve që ndërlihen me të pandehurin J.Gn, në asnjë formë pra këto prova nuk kanë të bëjnë me të provuarit e ndonjë elementi të veprës penale, paraqet një përshkrim të përgjithshëm duke mos specifikuar përshkrimin faktik të dispozitivit të kësaj aktakuzë për secilin të akuzuar veç e veç dhe duke mos specifikuar lidhjet e veprimeve apo mosveprimeve konkrete të personave tjerë në raport me të mbrojturin tim, prokuroria gabimisht interpreton faktet dhe pretendimet e saj janë komptabile me ligjin material dhe elementet e veprave penale konkrete, kështu gabimisht interpreton gjetjen e Ekspertizës duke u thirrur në çmimin më të lirë me rastin e shitblerjes së paluajtshmëris dhe këmbimit që janë objekt i akuzës duke paragjykuar shkeljet ligjore me një arsyetim retorik dhe në tërësinë e saj hipotetike, pasi që paragjykimi reflektohet në pretendimin e akuzues se në një të ardhme të afërt zonat ku gjenden pasurit i janë nënshkruar një zhvillim komercial, nuk janë duke u përdorur për qëllimet bujqësore dhe kërkesat e investitorëve janë duke u rritur kryesisht nga kërkesat për ndërtime banimi dhe komerciale. Për krejt këto palujtshmëri bartja e të drejtave pronësore nga një titullar të titullari tjetër i të drejtave pronësore nga këndvështrimi faktik dhe formal është konform legjislacionit në fuqi që përcakton rregullat e qarkullimit juridik, e kjo provohet me prova materiale të pa kontestueshme siç janë kontratat formale të lidhura, të noterizuara, të dëshmuara me transaksione bankare se për të njëjtat prona nuk ka patur asnjë lloj ndalesë apo pengese ligjore për shitblerjen apo këmbimin e këtyre patundshmërive. Është e rëndësishme se veçantë se në rastin konkret prokurori i çështjes me rastin e vlerësimit të çmimit të shitjes së patundshmërive bujqësore objekt i këtij akuza, nuk i ka vlerësuar farë këto prova edhe pse është dashur dhe ka patur për detyrë ti vlerëson provat fajësuese e krahas tyre edhe provat shfajësuese për të dyshuarin siç përcaktojnë dispozitat ligjore nga neni 7 i KPPRK-së, rrjedhimisht në analizën e çmimeve në kontratat e shitblerjes të patundshmërive të prezantuara nga drejtoria për kadastrë në Komunën e Prishtinës vërtetohet fakti se në këto kontrata kemi të

bëjmë me zonën kadastrale përafërsisht të njëjta apo në fqinjësi të njëra tjetrës, me periudha të përafërta kohore të shitblerjes kur është bërë edhe shitblerja apo këmbimi i paluajtshmërive që janë objekt i akuzës, dhe një pjesë dominante e kontratave të paluajtshmërive të prezantuara nga zyra e Kadastrit rezulton të jetë shitblerja me çmime me të ulëta të përafërta me çmimin që kanë paguar që të gjithë të akuzuarit e veçmas në rastin e të akuzuarit J.G, nga këto prova materiale nuk provohet fakti se çmimi i shitblerjes apo këmbimi si këtyre paluajtshmërive që janë objekt akuze paska pas qenë më i ulët se çmimi i tregut për atë periudhë kohore, po ashtu Prokuroria nuk ja ka bashkangjitur shkresave të lëndës ndonjë provë konkrete që do të rezultonte me krijimin e dyshimit se i mbrojturi im ka mundë të jetë në dijeni se patundshmëria objekt i këmbimit sipas kontratës së këmbimit LRP.nr.45/13, NR,REF.05/13, të datës 08.01.2013, paluajtshmëria në zonën kadastrale të Prishtinës, njësia kadastrale P-71914059 -0....., lloji i pronës private, zonë rurale, lloji i shfrytëzimit bujqësore se kjo paluajtshmeri nga këmbyesi i dytë I.S të jetë fituar në mënyrë të kundërligjshme, në këto rrethana J.G as që ka mundë të ishte në dijeni sepse vërtetimi i kësaj kontrate i është nënshtruar kontrollit strikt nga Institucionet e Sistemit të Drejtësisë duke filluar nga Administrata shtetërore për mes të dhënave kadastrale, vërtetimit të kësaj kontrate tek noteri kompetent, ngjashëm është me rastin e shitblerjes me kompensim të paluajtshmeris nga J.G tek z. Rexha, në këto zona të përafërta të kategorizuara si paluajtshmeri bujqësore nga kl.3 deri 6, të njëjtat janë shitblerje me çmime të ndryshme, determinuar nga çmimi i tregut, ofertës dhe kërkesës që ka përcaktuar edhe shprehjen e vullnetit të lirë dhe të plotë të palëve kontraktuese me rastin e lidhjes së një kontrate e që e drejta e disponimit dhe tjetërsimit të pronës private është e drejt themelore e garantuar me ligjet sistemore me Kushtetutë dhe në harmoni me konventat ndërkombëtare, andaj nuk është detyrë e blerësve (Palëve Kontraktuese) për ta vërtetuar prejardhjen e ligjshme të një prone, kjo për faktin se kjo detyrë është e institucioneve relevante të sistemit juridik të shtetit dhe ate duke filluar nga të dhënat kadastrale ku janë të regjistruar pronarët e paluajtshmerive, të dhëna këto të pasqyruara në regjistrat publik të kadastrit ku kanë qasje te gjitha subjektet e interesuara dhe se vetëm ekzistimi i kësaj mundësie paraqet rrethanë të mjaftueshme për ta besuar dhe mos dyshuar se origjina e pasurisë buron apo mund të burojë nga krimi, kjo edhe për faktin se regjistrimi i paluajtshmerive në regjistrat kadastral i nënshtrohet një ser veprimeve procedurale të cilat duhet ndërmarr konform ligjeve në fuqi për të ardhur deri tek veprimi final regjistrimi i paluajtshmerisë, hapat procedural i mbrojturi im i ka ndjekur ne pajtim të plotë me rendin ligjor e që në hallkat e këtij zingjiri janë respektuar procedurat që përcakton ligji si; Hartimi dhe vërtetimi i kontratës për shitblerje dhe këmbimi është realizuar brenda kornizës ligjore, është vërtetuar tek noteri kompetent i cili edhe bënë verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore për lidhje të ligjshme të kontratës, realizimi i kompensimit dhe pagesave, mos ekzistimi i ndonjë barre ndalese apo hipoteke apo të ndonjë mase të përkohshme të sigurisë për ndalimin e bartjes së të drejtës presonit tjetër e fitimit të pronësisë për ato paluajtshmeri që mund të ishte ndonjë vendim gjyqësor për fitimin e të drejtës së pronësisë, respektimi dhe ndjekja e të gjithave hapave procedural të përshkruar më sipër objektivisht e përjashton dijeninë e palës me interes juridik se në këto paluajtshmeri ka apo ka patur diçka kontestuese apo kundërligjore, andaj prokuroria në mbështetje të akuzës nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të bërë të besueshëm dyshimin e bazuar mirë se këmbyesit përkatësisht shitblerësit e patundshmerive objekt i akuzave në rastin konkret i mbrojturi im të ketë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës përmes të cilave prova do të rezultonte dyshimin eventual i bazuar mirë se i njëjti ka ditur apo ka mundur te ishte në dijeni se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral, flete poseduesit në emër të I.S apo kudo tjetër ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që duke i ditur këto veprime i njëjti ka ndihmuar sidomos I.S apo B.R për kryerjen e aktiviteteve kriminale apo se ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin me I.S apo dikën tjetër, se pretendimet e prokurorisë se kinse paluajtshmerit janë shitur me çmimin më të ulët se çmimet e tregut nuk janë mbështetur në provat materiale të besueshme ashtu që nuk ka arritur të provuarit me prova

për të mbështetur dyshimin ngase përveç interesit ekonomik të të akuzuarit për të mbështetur nevojat e tij jetësore që derivojnë nga pronat legjitime, nuk ka ndonjë motiv tjetër veçmas sipas pretendimeve paragjyquese të Prokurorit të çështjes, Nisur nga fakti jo kontestuese se i mbrojturi im si këmbyses i parë dhe shitës nuk ka ditur bazën e fitimit të pasurisë nga titullari i mëparshëm I.S apo SH.S, determinohet nevoja e sqarimit përmes pyetjes se cilat janë ato prova në shkresat e lëndës që vërtetojnë rrethanën relevante kryesore se kontraktuesit kanë qenë në dijeni se pronësia është fituar nga aktiviteti kriminal i të akuzuarit G... dhe R...., është e kundërta se nga shkresat e lëndës është imponuar besimi i të akuzuarit G.... po edhe R..... se pronësia është fituar në procedurë të rregullt, ngase titullari ishte i regjistruar pronar në regjistrat kadastral, vlerësojm se në shkresat e lëndës nuk egziston ndonjë provë që dëshmon dhe provon ekzistimin e kësaj rrethane se kontraktuesit përkatësisht i mbrojturi im ka ditur apo ka qenë i detyruar apo ka mundur të dijë se dokumentet përmes të cilave është bërë regjistrimi i të drejtës së pronësisë në regjistrin kadastral dyshohet se është përcjell me veprime e aktivitete kriminale. Në pikën 15 të aktakuzës në dispozitivin për të mbrojturin tim pretendonte pos tjerash se duke e ditur ose duke pasur arsye për të ditur se parcelat e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale posaqërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht tek persona të etnitetit serb por ne fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal të përshkruar nën pikën 1 të aktakuzës si rezultat i veprimtarive kriminale të përshkruar në pikat 1 deri 19, në bashkëpunim me I.S dhe SH.S siç pretendonte me shitësin dhe blerësit e parcelës së tokës ai ka transferuar dhe ka tentuar të transferoj pronat me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës burimit sistemimit lëvizjes dhe pronësisë së pronave apo në çfarëdo rrethanash me qëllim të asistimit të të pandehurve të tjerë të cilët ishin përfshirë apo kishin qëllimin e përfshirjes në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore për veprimet e tyre në veçanti. Me datë 31 tetor 2012, ai ka marrë autorizim nga I.S për të vepruar në emër të tij në çështjet që ndërlihen me parcelën numër 1870/10, me datë 8 janar 2013, ai ka lidhur një marrëveshje me I.S dhe ndërmarrjen e tij “ ..”, nëpërmjet të cilës i është miratuar e drejta pronësore mbi parcelën e tokës nr.1870/18 ..... Me datë 4 mars 2013, duke përfaqësuar ....., ai transferoi parcelën e tokës 1870/18 (60 euro për m2) me sa duket paguar me mjetin motorik “BMW X6”, në vend të parave, për vërtetimin e këtyre pretendimeve prokuroria nuk ka bashkangjitur asnjë provë konkrete që do të vërtetonte dyshimin për akuzat në ngarkim e të mbrojturit im duke mos përshkruar rrethanat se si kur me çfarë mjete ka ndihmuar, në ç’ mënyrë i ka ndihmuar Ilaz e SH.S, cili ishte motivi për ti ndihmuar të njëjtit, e gjithë analiza e më sipërme provon se gjykata nuk do duhej që këtë çështje ta dërgoj në shqyrtimin kryesor, në pikën pararendëse e bënë të bazuar edhe pretendimi i Prokurorisë, bazuar në vlerësimin e ekspertëve ndërkombëtarë se parcelat e tokës gjendeshin në zonën bujqësore në shtator të vitit 2010, zonat ku gjenden pasurit i janë nënshtruar një zhvillimi komercial nuk janë duke u përdorur për qëllime bujqësore dhe kërkesat e investitorëve janë duke u rritur kryesisht nga kërkesat për ndërtime banimi dhe komerciale, ky paragjykim i prokurorisë e bënë të pamundur vërtetimin e një dyshimi të bazuar ngase ngjarjet e ardhshme të pasigurta nuk përcaktojnë përgjegjësinë penale në çështjen penale, nuk ka prova te pranueshme dhe prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i mbrojturi im ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet në aktakuzë, fakti se nuk ka veprim kundërligjor e as qëllim për të dëmtuar ndonjë subjekt e përfshira në këtë proces, pasoja që është element qenësor i figurës së veprës penale mungon, me këtë akt akuzues nuk ka as përshkrim të veprimeve faktike veç e veç, nuk ka datë dhe vend e as mënyrë të përshkruar faktike, pretendimet shterpe të prokurorisë nuk mbështeten në fakte dhe prova të pranueshme dhe të besueshme, kjo nga fakti se nuk ka përgjegjësi penale në mungesë të veprimit konkret të dashjes dhe pasojës, se aktakuza është e mangët formalisht për shkak se nuk përputhet me kërkesat e specifikuar në nenin 241 (1.4) të KPP-së, lexuar së bashku me nenin 2 (3) të KPP-së. është e argumentuar se “Prokurori nuk ka përcaktuar saktësisht definicionin e veprave penale” përbën



shkelje jo vetëm të nenit 241(1.4) të KPP-së, por gjithashtu të parimit të ligjshmërisë neni 3 (2) i KPP-së, në veçanti, vendndodhja e saktë, koha dhe qëllimi i veprimeve apo mos veprimeve të veçanta nuk janë përcaktuar në Aktakuzë sa i përket pikës 15 të pjesës në aktakuzë, është gjithashtu e nevojshme që vendi dhe data e saktë të përmendet në aktakuzë, për sa kohë veprimi është në mënyrë të pa qartë, i identifikueshëm dhe i dallueshëm, se ekziston rreziku që veprimi i akuzuar të mund të ngatërrohet me veprimet tjera, pasi që nga leximi i aktakuzës si tërësi duhet të shihet si e tillë që ofron informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar që i lejon të pandehurve që të përgatisin mbrojtjen e tyre në mënyrë adekuate dhe efektive, andaj kërkojmë nga gjykata që aktakuza të hudhet sepse e ngarkon të pandehurin për të njëjtin veprim penal me tjetër veprë, bazuar në teorinë e marrëveshjes në veçanti parimi i specialitetit i pandehuri nuk mund të konsiderohet penalisht përgjegjës për dy veprat penale, për të njëjtin veprim penal me disa vepra penale, për të mbështetur këtë qëndrim mbrojtja i referohet aktvendimit të Gjykatës së Apelit në rastin kundër Uka et al të datës 17.04.2013, pasi që konsideroi në këtë rast se prokurori në mënyrën efektive ka ngarkuar të pandehurin për të njëjtin aktivitet penal me dy vepra penale dhe gjeti se kualifikimi kumulativ për të njëjtin veprim të pretenduar përbënë një gabim në ligj, pasi që nuk ka asnjë provë në mbështetje të pretendimit të aktit akuzues për veprat penale që i vihen për barrë mbrojturim tim, andaj propozon që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale kundër të pandehurve J.Gt ngase nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzë.

Në afatin ligjor i pandehuri B.R ka bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave që është dorëzuar në gjykatë me datë 22.06.2021, i njëjti kërkon nga Gjykata që të hudhet aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, pasi që konsideron se aktakuza e paraqitur kundër tij me gjithë sqarimin në arsyetimin e dhënë është i pa qartë, kontradiktor dhe i pa sistemuar, pasi që sipas aktakuzës citohet se me datë 04 mars 2013, i pandehuri B.R ka përvetësuar parcelën e tokës 1870/18, në ..... nga i pandehuri J.G duke përfaqësuar ....., për çmim artificialisht të ultë prej 60.000 euro, 60 euro për m2, me sa duket paguar me një mjetë motorik “BMW X6”, në vend të parave, ndërsa gjykata gjen se të gjitha pretendime e cekura në kërkesën e të pandehurit B.R janë të njëjta me pretendime e mbrojtësit të pandehurit J.G të cekura më lartë, pa dashur të përsëriten të njëjtat, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 05.05.2016, i pandehuri B.R ka deklaruar se kamë blerë parcelën e tokës nga J.G në këmbim për një mjetë motorik që ka pasur vlerën prej 65.000 euro, të njëjtën parcele e kamë blerë për fitim dhe investim, tash e kamë shitë të njëjtën parcelë për arsye se kam pas nevojë për të holla për të rindërtuar objektin e biznesi që më ishte djegur, nuk e kamë ditur pronarin e më parshëm të tokës dhe nuk e kamë ditur qe ajo tokë është pronë shoqërore, kur ata provuan të regjistrojnë token në emrin tim, kadastru ju ka thënë se parcela nuk mundë të ndahet, me pas të gjithë token e kanë qitë në emrin tim, ndërsa unë atë i kamë pas vetëm 5 ari tokë, andaj në bazë të gjithave të lartcekurave propozon që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale kundër tij ngase nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzë.

Në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit J.L, av.M.R ka dorëzuar kërkesë për hudhje të aktakuzës, që është dorëzuar në gjykatë me datë 16.06.2021, ku propozon që të hudhet aktakuza PPS. nr.54/14, të datës 24.10.2016, për shkak se ka bazë të artikulushme që gjykata të çmoj provat si thelbësishtë të pa mbështetshme konform nenit 249 par. 1.3 i KPPRK-së, me këtë aktakuzë akuzohet i mbrojturi im për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, tani kur jepet përshkrimi faktik thuhet “ duke ditur ose duke pasur arsyeje për të ditur se parcela e tokës në pronësi shoqërore të cekur me poshtë janë fitim i krijuar me aktivitet kriminalë, posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht te personat e etnitetit Serb,

por në fakt në kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal...”, për vërtetimin e këtyre fakteve dhe rrethanave Prokuroria Speciale mbështetet në të dhënat të thashethemeve, kurse i apstrahon provat valide, nga të cilat është e qartë se i pandehuri në momentin e bisedave që zhvilloj me personat që iu ofruan blerjen e palujtshmëris njësisë .....2, nuk kishte njoftim, as ide se si është zhvilluar historiku i mbajtjes së pronësisë në emër të personit, në emër të cilit është regjistruar kjo pasuri në librat kadastrale, por që kishte informatë që kjo tokë më parë kishte qenë pronë e Serbëve e realizuar me vendimin valid gjyqësorë, e për të hjekur dyshimin se ka diçka kundër ligjore në përfitimin e kësaj pasurie në emër të shitësit, paraprkishtë nga shërbimi kadastral i KK Prishtinë, bashkë me bashkë blerësin Haxhosaj u pajisen me certifikatë valide se shitësi ishte pronar legjitim i saj dhe se ai ka të drejtë që çfarë do qoftë transaksionit të pronësisë. Prokuroria kishte në posedim provat e duhura që vërtetojnë në këto fakte dhe rrethana, pra se pasuria ishte fituar në mënyrë të ligjshme dhe se ishte i ligjshëm çdo veprim i pronarit i cili e kishte nxjerr në shitje por për të krijuar afer më të madhe tani me akuzën e kundërshtuar akuzojnë të pandehurin J.L si dhe bashkë blerësit e kësaj palujtshmerie edhe pse të gjitha veprimet e tij ishin veprime ligjor, pasi që për blerjen e kësaj palujtshmerie kishte siguruar mjete të gatshme financiare me shitjen e një toke që posedonte në Pejë, por ato nuk ishin mjete të mjaftueshme, bijtë e tij dhe ai vetë kërkuan kredi nga bankat afariste të cilëve kredia iu akordua dhe ata siguruan mjetet e mjaftueshme për pagesën e çmimit të kontraktuar, lidhur me këto të dhëna i pandehuri gjykatës i ofroi provat e duhura, certifikatën nga shërbimi kadastral i Komunës së Prishtinës, kopja e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.br.1164/90, e datës 24.06.1992, i plotfuqishëm me datë 16.10.1992, dokumentacionin e bankave afariste të cilat i pandehuri dhe binjët të tij kishin marr kredinë e nevojshme, pasi që në aktakuzën e kundërshtuar nuk jep prova të cilat argumentojnë që veprimet e të pandehurit përmbajnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, por vetëm supozime dhe vlerësime të pa argumentuara në arsyetimin e akuzës i cili është aq konfuz saqë nuk mundë të kuptohet asgjë, pra blerja e parcelës ishte legjitime dhe ishte kryer me mjete financiare në mënyrë legjitime dhe ky është një argument i fuqishëm se nuk ishte shpëlarje parash siç parasheh neni 56 par. 1 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizimit, pra i propozojmë gjykatës të gjitha provat të konsiderohen si prova të pa pranueshme, ndërsa provat të prezantuara nga i pandehuri të vlerësohen pasi që nuk argumentojnë se në veprimet e tij ka elemente të veprës penale për të cilat është ngritur kjo aktakuzë, pasi që dispozitivi i kësaj aktakuze është konfuze, e pa caktuar dhe e pa kuptueshme, një akuzë e tillë ku nuk përcaktohet se cili ligj, dhe cilës pikë i përket vepra për të cilën akuzohet i pandehuri dhe sipas saj nuk mundë të veprohet, pasi që prokuroria nuk e ka ceke se cila është vepra konkrete, andaj propozohet që të hudhet aktakuza ndaj të mbrojturit tim pasi që vepra për të cilën akuzohet nuk përmban veprën penale nga neni 253 par. 1 .1 të KPPRK-së , dhe se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në akuzë konformë neni 253 par. 1.4 të KPPRK-së .

Në afatin ligjor i pandehuri A.H ka bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave që është dorëzuar në gjykatë me datë 29.06.2021, e kundërshton akuzën si dhe përskrimin faktik ku thuhet:” duke ditur ose duke pasur arsye për ta ditur se parcela e tokës në pronësi shoqërore të cekura më poshtë janë fitim i krijuar me aktivitete kriminale posaçërisht se pronësia e këtyre pronave ishte transferuar zyrtarisht te personat e etnitetit serb, por në fakt nën kontrollin dhe posedimin e grupit të organizuar kriminal“, për vërtetimin e këtyre fakteve dhe rrethanave Prokuroria Speciale mbështetet në të dhënat të thashëthënave, kurse i apostron provat valide nga të cilat është qartë se unë në momentin e bisedave që zhvillova me persona që me ofruan blerjen e patudëshmëris – njësia .....2, nuk kisha njoftim, e as ide se si është zhvilluar historiku i bartjes së pronësisë në emër të personit të të cilit ishte e regjistruar kjo pasuri në librat kadastral, pos që kishte informatë se ajo tokë më parë kishte qenë pronë e serbëve e realizuar me

vendim valid gjyqësor, e për ta hjekur dyshimin se ka diç kundërligjore në fitimin e kësaj pasurie në emër të shitësit paraprakisht nga shërbimi kadastral i KK Prishtinë, bashkë me bashkëblerësin J.L u pajisëm me çertifikata valide se shitësi ishte pronar legjitim i saj dhe se ai ka të drejtën e çfarëdo qoftë transaksioni të pronësisë., andaj Prokuroria kishte posedim provat e duhura që vërtetojnë këto fakte dhe rrethana, pra se pasuria ishte fituar në mënyrë legjitime dhe se ishte i ligjshëm çdo veprim i pronarit i cili e kishte nxjerrë në shitje, por për të krijuar aferë më të madhe tani me aktakuzën e kundërshtuar më akuzoi mua si dhe bashkëblerës e kësaj patudëshmërie, ndonëse të gjitha veprimet e mia ishin veprime ligjore, pasi që unë për blerjen e kësaj patudëshmërie kisha siguruar mjetet të mjaftueshme për pagesën e çmimit të kontaktuar nga kursimet e mia financiare si dhe me një kredi të akorduar në vlerë prej 29.000.00 euro, nga banka Procredit në Prishtinë, po ashtu isha i mbështetur nga bashkëshortja dhe motra ime e cila jeton në bashkësinë time familjare, andaj propozon që të gjitha provat tjera të cilat nuk janë prova konkrete lidhur me veprimet e mia të konsiderohen si prova thellësisht të pa mbështetshme dhe si të tilla ato të mbyllura të veçohen nga shkresat e lëndës konform neni 249 par 1.3 të KPPRK-së, pasi që provat materiale të elaboruar nga unë, në veprimet e mia nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilat akuzohem, nga shkak se të gjitha veprimet lidhur me shitblerjen e patudëshmëris, ishin veprime të lejuara dhe të ligjshme, kështu që një gjendje të tillë nuk ka vend për akuzim, andaj i propozon gjykatës që ta hudhë akuzën në kuptim të nenit 253 të KPPRK-së, për shkak se vepra me të cilën akuzohem nuk përbënë vepër penale si dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se kamë kryer veprën penale për të cilën akuzohem.

Prokurori i prokurorisë speciale në seancën e shqyrtimit të dytë me datë 06.07.2021, lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës deklaroi se në pergjegjjen te kërkesave për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të parashtruara nga të pandehurit respektivisht mbrojtësit e tyre, konsiderojmë se të njëjtat kryesisht përmbajnë historikun e negociatave dhe blerjes së parcelave nga të pandehurit dhe nuk përmbajnë analizë ligjore apo nuk mbështeten në prova konkrete sepse realisht duhet të hudhet aktakuzë apo pse provat që e mbështesin aktakuzën duhet të shpallen prova të pa pranueshme .Të pandehurit në kërkesat e tyre veprimet e tyre mundohen ti arsyetojnë duke ju hedhur fajin noterëve që kishin hartuar kontratat përkatëse, personat zyrtarë që kishin punuar në Komunë në drejtorin kadastrale e cilët kishin lëshuar çertifikatat e parcelave, skicat etj. Si dhe shitësve paraprak në pretendimin se ata i kishin mashtruar të pandehurit dhe kinse se të pandehurit nuk ishin në njohuri se si shitësit paraprake e kishin fituar pronësinë e parcelave në fjalë që po ua shitnin .Të gjithë të akuzuarit në përgjithësi në kërkesat e tyre për hudhje të aktakuzës kanë potencuar se nuk ka prova të mjaftueshme që e mbështesin ekzistimin e dyshuar mirë se ata kanë kryer veprën penale që ju ngarkohet, në anën tjetër kanë parashtruar edhe kërkesë për kundërshtim të provave, në këtë situatë shtrohet pyetja logjike a ka apo nuk ka prova që e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale që ju ngarkohet, nëse ka prova le të kundërshtojnë ato duke dhënë arsyeje pse nuk janë prova të pranueshme por nuk mund të thuhet se nuk ka prova pasi që nëse thuhet se nuk ka prova atëherë shtrohet pyetja pse behet kundërshtimi i provave cilat prova po kundërshtohen .Po ashtu shumica prej të pandehurve në tentativat e tyre për të sqaruar historikun e blerjes së parcelave dhe prejardhjen e pasurisë kanë theksuar se parcelat i kishin blerë me fituara me punë apo parat e siguruar për mes kredive bankare , parat e mara hua nga ndonjë familjare me të cilin e kishin ndarë parcelën, mirëpo asnjëri nga të pandehurit nuk ka dëshmuar në prova materiale se në çfarë pune janë fituar mjetet apo parat në të cilat janë blerë parcelat, si arritën të pandehurit të sigurojnë kredi nga cilat bankë kishin siguruar kredi , çfarë pasurie kishin lënë peng apo hipotek për të siguruar kredi, parat e mara hua nga familjari, ku i mori familjari, pse nëse prona ishte blerë për gjysmë me familjarin në kontratë figuron vetëm një blerës dhe si arritën që të pandehurit të bin në kontaktë dhe të

blejnë prona me çmimet përkatëse që i kanë blerë .Duke u bazuar në këto që u thamë gjykatës i propozojmë që të marr aktvendim me të cilën do të refuzoj kërkesat e të pandehurve me qenë se konsiderojmë se aktakuza është në përputhje të plotë me nenin 241 të KPPK-së, i përmban të gjitha elementet e domosdoshme të parapara në këtë dispozitë, është e mbështetur në prova të mjaftueshme të ligjshme dhe të pranueshme me të cilat vërtetojnë qartë gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, si përmbledhje e gjitha asaj çka u tha vlerësojmë se pretendimet e mbrojtësve dhe të pandehurve rreth aktit akuzues dhe provave janë të pa bazuara andaj gjykatës i propozojmë që të caktoj shqyrtimin kryesor apo gjyqësor në të cilin do të administrohen provat e propozuara nga të cilat konsiderojmë se gjykata do të bindet që këta të pandehur kanë kryer veprën penale për të cilët akuzohen .

Kryetarja e trupit gjykues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve si dhe të pandehurit B.A av. K.K, H.H av. A.B, A.H av.R.K, V.SH av.H.H, S.P av. T.ZH, M.K av. F.U, XH.B, N.SH av.S.M, S.B av. A.M, I.B, SH.L, E.C av. Teuta Qaushi, J.G av.I.D, B.R, J.L av.M.R dhe A.H, përkitazi me kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave, dhe përgjigjes së prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, vlerësoi se pretendimet e mbrojtësve dhe të akuzuarve për hudhjen e aktakuzës, dhe kundërshtimin e provave janë të bazuara për faktin se gjykata ka vlerësuar se nuk ka prova të mjaftueshme që e mbështesin ekzistimin e dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale sipas kësaj aktakuze.

Kryetarja e trupit gjykues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjen se kjo çështje penale përfshinë parcelat e shumta të tokës, pronësia e të cilave disa dekada më parë u transferua nga individ të ndryshëm tek ndërmarrjet shoqërore, në vitin 1990, ligjshmëria e disa kontratave të shitjes të cilat lehtësuan këtë transferim të pronësisë është shqyrtuar nga Gjykata Komunale ku në disa raste janë lëshuar vendime të cilat kanë anuluar kontratat e shitjes të më parshme dhe kanë urdhëruar kthimin e parcelave të tokës së konfiskuar nga ndërmarrja shoqërore “KBI .....”, tek pronarët e tyre historik, e grupi i organizuar kriminal që akuzohen në pjesën e toka 1, përfiton nga rasti i individëve të cilët kanë vendime gjyqësore duke rivendosur tullarin e tyre për ish tokën e familjes së tyre, këta individë janë të përkatësisë etnike Serbe dhe disa prej tyre janë larguar nga Kosova si rezultat i luftës së vitit 1999, e ky rast fokusohet në parcelat e tokës për të cilat titullari i së drejtës pronësore u bart nga tri familje, të cilat u vunë në shënjestër nga grupi i krimit të organizuar, e këto familje janë S....., S.... dhe Vujoviq, duke marrë aktvendimet origjinale nga familjet Serbe, grupi ka marr dosjen origjinale gjyqësore për procedurat të cilat rezultuan me vendimet e gjykatës nga arkivat e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe arkivit Shtetëror të Kosovës, dosje gjyqësore u ndryshuan më pas dhe dokumentet u falsifikuan, të gjitha dokumente i referohen parcelave të tokës të cilat fillimisht ju kanë kthyer familjeve Serbe, janë larguar dhe janë zëvendësuar me dokumente të reja të rreme ku vend ndodhja e dokumenteve origjinale është e pa njohur, në këto dokumente të falsifikuar përmbajnë ngastrat ekzistuese plus ngastrat shtesë, i ka zëvendësuar në tërësi ngastrat ekzistuese me emra tjerë të regjistruar në pronësi të ngastrave të KBI “ .....” të cilat kanë pas vlerë më të lartë se sa ngastrat origjinale që thekson me vendim, ku dosjet e ndryshuar gjyqësore janë kthyer më pas në Arkivën e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në arkivën Shtetërore të Kosovës. Grupi ka vepruar në bazë të autorizimit ku shumica prej këtyre autorizimeve janë të falsifikuara, pasi që anëtarët individual të familjes të cilët janë të dyshuar se kanë bashkëpunuar me grupin kanë nënshkruar këto dokumente të autorizimit për veten e tyre dhe kanë lehtësuar falsifikimin e nënshkrimeve të anëtareve të tjerë të familjes, ku disa anëtar të familjes kanë nënshkruar dokumentet në bazë të mirëbesimit duke besuar se dokumenti ish diçka tjetër ose nënshkrimet e tyre janë falsifikuar, flet autorizimet janë vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë ,

Graqanicë dhe Vushtrri ku janë vërtetuar me ndihmën e nëpunësve nëpër gjykata, ku janë përfshirë edhe autorizimet e vërtetuara të cilët janë vënë nga personat që në fakt kanë qenë të vdekur në atë kohë. Dokumente autentike apo të falsifikuara të autorizimit janë përdorur për të ekzekutuar aktvendimet gjyqësore të falsifikuara, grupi kriminal ka përdorur dokumente për të lehtësuar transferimin e pronësisë nga KBI “.....”, në emër të përfitueseve në zyrën katastrale Komunale, ku e njëjta zyre ka autorizuar transferimin e parcelave të tokës pa miratim nga AKP-ja, pa varësisht nga fakti që këto tri familje nuk kishin qenë pronare të parcelave të tokës të shënuar në dokumentet e falsifikuara të paraqitura në këtë proces.

Gjykata vlerëson se historia dhe progresi i marrëdhënieve të grupit me secilën familje Serbe tani është adresuar një nga një, si rasti S...., ku toka e familjes S.... ishte parcela 106/2, 254/4, 794, 1369, dhe 1871/2, të ndodhur në Llapnasele, kjo tokë është marrë nga familja nëpërmjet një kontrate të shitjes OV.br. 2747/63, të datës 23.10.1963, me KBI “.....”. Parcela 254/4 dhe 254/6 dhe 1871/2 i janë kthyer familjes trashëgimtare e B.S, përkatësisht nofka S...., Vukasin S...., Grooljub S...., Gordana S.... dhe Jelena S.... me datë 19.10.1993, me aktgjykim të Gjykatës P.nr. 1880/89, familjes i është dhënë kompenzim financiar sa i përket parcelave 106/2, 794, dhe 1369. Aktgjykimi fillestar për kthimin e tokës familjes S.... është riprodhuar, aktgjykimi i falsifikuar tregon se tri nga parcelat janë kthyer familjes, parcela 254/4, 254/6, dhe 1871/2, por parcela të tjera janë shtuar ....., 1874/3, ....., ....., dhe 258/4 në Llapnasele, 1513/1, 1507/1, 1506/1, 1514/1, dhe 1515/1, në Qagllavic dhe 24 në Preoc. Vlen të përmendet se ky është rasti i vetëm ku parcelat origjinale të tokës në pronësi të familjes Serbe nuk janë fshirë dhe zëvendësuar me të tjerat por janë lënë në aktgjykim, ndërsa parcelat e tjera janë shtuar. Arkiva nder komunale e Prishtinës ka siguruar kontratën OV.br. 2747/63, që numron parcelat 106/2, 254/4, 794, 1369, dhe 1871/1, dhe një vendim që përputhet i Kuvendit Komunal të Prishtinës, i datës 10.10.1963, ku kjo përgjigjeje u konfirmua nga përgjigja e AKP-së, e cila ka vënë një dokument të brendshëm duke konfirmuar se Borivoje S.... ka shitur të njëjtat parcele me një kontratë me të njëjtin numër referencë dhe një kopje e aktgjykimin me numër P.nr. 2880/09, që liston të njëjtat parcele, ndërsa me datë 20.04.2006, S.H- ish drejtor i zyrës kadastrale ka lëshuar një vendim mbi aprovimin e përmbartimit të aktgjykimit P.nr.2880/09, dhe ka bërë ndërrimin e pronësisë të ngastrave 1513/1, 1507/1, 1506/1, 1514/1, dhe 1515/1, në Qagllavic në emër të Novka S...., po ashtu ditën e njëjtën ai i lëshoj edhe dy vendime tjera dhe aprovoi transferimin e pronësisë së ngastrave ....., 1874/3, ....., ....., dhe 258/4, në Llapnasellë, ngastra 24 në Preoc në emër të N.S, me çka këto vendime janë krejtësisht të pa ligjshme, pasi që janë bazuar në aktgjykimin e falsifikuar që e ka prezantuar grupi kriminal, pasi që 5 anëtar të familjes së Steviç u bënë pronar të ngastrave të tokës, ata gjëja se i nënshkruan katër autorizime në favor të E.Gt për ti shitur tokat në emër të tyre, të cilat autorizime janë të vërtetuara pranë Gjykatës Komunale në Graqanicë me datë 04.05.2006, nga nëpunësja M.V, me pas E.G më vonë ja barti autorizimin SH.S, kjo bartje është vërtetuar me datë 26.05.2006, pranë Gjykatës Komunale në Graqanicë, nga nëpunësja e lartcekur, ku më pas E.G dhe SH.S gjëja se janë të autorizuar nga anëtarët e familjes Steviç ti shesin të gjitha ngastrat e tokës. Parcelat e tokës janë shitur dhe trajtuar si më poshtë: Ngastra ..... në Llapnasellë, me 29.05.2006, anëtarët e familjes Steviç për mes personit të autorizuar SH.S i ka shitur këtë parcelë 1,770 m2 për A.V, për një çmim prej 9,000€, ky është një çmim prej 5.08m2. Me datë 19.07.2006, A.Vi përfaqësuar nga Q.G (i cili ishte vozitës i F.Gt), ka shitur parcelën F.G për një çmim prej 44.250 €, ky është çmimi prej 25 € për m2. Me datë 05.09.2006, F.G ka shitur këtë parcelë A.H për një çmim prej 49.560 €, ky është çmimi prej 28 € për m2. Ngastrat ..... dhe ..... në Llapnasell, me datë 24.05.2006, anëtarët e familjes S...., për mesë personi të autorizuar E.Gt i kanë shitur këto parcele me një sipërfaqe të përgjithshme prej 3.942 m2, B.At për një çmim prej 82.100 €, ky është çmimi prej 20.83 € për m2. Me datë 18.10.2006, B.At i ka shitur këto parcele H.Ht për një çmim prej 80.000 €, ky është çmimi prej 20.29 € për m2.

Nga shkresat e lëndës shihet se toka e familjes S.... ishte parcela 1336 e ndodhur në Lapnasellë në një sipërfaqe prej 7,327m<sup>2</sup>, kjo tokë është marr nga familja nëpërmjet një kontrate të shitjes Ov.br.3274/63, e datës 11.12.1963, me KBI ....., por i është kthyer familjes Ljubisha S.... me datë 27.03.1997, me aktgjykimin e Gjykatës me numër P.nr.560/95, nga shkresat e lëndës ekzistojnë rrethanat se kontratat e shitjes dhe aktgjykimi janë riprodhuar dhe parcelat e tokës 1336 u zëvendësua me parcelat e tokës 1877/1 , 1877/2, 1877/5, 1877/7, 1877/8,1877/9, dhe 1878/1 , me një sipërfaqe të përgjithshme prej 40,834m<sup>2</sup> të ndodhura në Lapnasellë .Kopje të dy grupeve të dokumenteve origjinal dhe falsifikuara ekzistojnë, dy versionet e aktgjykimeve mbajnë numër të njëjtë të gjykatës, i referohen të njëjtës kontratë të shitjes dhe mbajnë datën e njëjtë, i vetmi dallim është numrat e parcelave të tokës. Agjencia Kosovare e privatizimit ka dhënë një dokument nga vitit 1965, i cili tregon se familja S.... kishte shitur “.....it“, parcelën 1336 në bazë të kontratës së shitjes OV.br. 3274/63, gjithashtu AKP-ja ka dhënë një letër të vitit 2007, dërguar në Gjykatën Komunale ku ka kërkuar nga gjykata që ndalohet kryerja e transaksioneve që lidhet me parcelat 1877/1 , pasi që aktgjykimi P.nr. 560/95, ishin nën hetime penale për falsifikim . Arkivi nder komunal në Prishtinë ka siguruar një kopje të kontratës së shitjes në lidhje me parcelën 1877/1, por edhe një kopje të vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës i datës 16.12.1963, duke i referuar parcelës 1336 , ku dosja kadastrale për parcelën 1877/8, përmbajnë dokumentacionin në lidhje me një person të quajtur T.N, i cili kishte shitur këtë parcelë “.....in “ në vitin 1963, me çka është e pa mundur që edhe Trajko Nedeljkoviqi dhe Ljubisha S.... ta kenë shitur të njëjtën parcelë. Me datë 14.02.2007, Krana Blagojeviq-vajza e Ljubisha S...., në emër të M.S ka paraqitur një kërkesë në zyrën kadastrale në Prishtinë për ndryshuar pronësinë e parcelës së tokës 1877/1, nga KBI “.....” bazuar në vendimin e gjykatës P.nr. 560/95. Duke vepruar sipas kërkesës të njëjtës S.H - ish drejtor i zyrës kadastrale beri pyetje pranë Gjykatës Komunale dhe Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit, N.U ish Kryetar i Gjykatës Komunale të Prishtinës u përgjigj me datë 05.04.2007, duke konfirmuar vendimin e gjykatës, që ishte në arkivën e Gjykatës dhe përgjegjës së tij ja bashkëngjiti këtë vendim të falsifikuar. Me datë 27.04.2007, AKPM-ja informoi zyrën kadastrale se vendimi në arkivin e saj ishte e ndryshme, me gjithat me datë 07.05.2007, S.Hlëshoi një vendim për miratimin e ndryshimit të pronësisë për Lubica S...., në mënyrë të ngjashme me rastin S...., ky vendim është krejtësisht i pa ligjshëm për shkak se K.B nuk ka pasur autorizim në emër të ndonjë prej anëtareve të familjes së saj dhe se nuk ka pasur pëlqimin nga AKP-ja dhe është bazuar kjo procedurë në vendimin e falsifikuar. Me datë 15.05.2007, zyra kadastrale ka lëshuar listën poseduese që të deklaroj se Lubica S.... ishte pronare të gjitha parcelave të tokës 1877/1 për veç parcelës 1877/8, ku vlen te cekes se për parcelën e njëjtë ka qenë në vazhdimësi në procedurë T.N, me çka S.Hka nxjerrë vendim në favor të tij, duke ja transferuar komplet parcelën e tokës 1877/8. Me datë 05.06.2007, K.B, S.S dhe S.M, si duket i ka dhënë autorizim SH.S për të vepruar në emër të tyre në Gjykatën Komunale në Prishtinë në lidhje me një procedurë trashëgimore dhe për regjistrimin e tokës së trashëguar, dosja e trashëgimit tregon se tri autorizimet janë nënshkruar personalisht nga tri motrat e lartcekura të vërtetuara nga nëpunësja B.A, ku dyshohet se këto autorizime janë të falsifikuara, ku me të njëjtën datë SH.S ka iniciuar procedurën trashëgimore në Gjykatën Komunale duke kërkuar në gjykatë për të miratuar trashëgimin nga Ljubica S.... vetëm tek K.B dhe ka kërkuar transferimin e pronës për parcelën e tokës 1877/1 nga Ljubica S.... në K.B. Nga shkresat e lëndës Gjykata gjen se K.B u bo pronare e parcelave të tokës brenda një jave me datë 13.06.2007, Gjyqtari N.U ka nxjerrë një vendim të trashëgimisë dhe ka aprovuar trashëgimin e të njëjtës si trashëgimtare e vetme, ku SH.S në emër të K.B i ka shitur të gjitha parcelat e tokës dhe janë trajtuar si më poshtë : Parcela 1877/1, në Lapnasellë, me datë 29.06.2007, K.B, e përfaqësuar nga SH.S, ka shitur këtë parcelën me sipërfaqe prej 3,457m<sup>2</sup> , XH.Bt për një çmim prej 51.700€, ky është çmimi prej 14.96m<sup>2</sup> . Me 08.03.2008, XH.B i ka shitur këtë parcelë N.SH për një çmim prej

51.855 €, ky është çmimi prej 15€ për m2. Parcela 1877/2 në Lapnasellë, me datë 11.09.2007 ,SH.S në emër të K.B, ka shitur këtë parcelë me sipërfaqe prej 5,471m2, M.Kn, për një çmim prej 156.750 €, ky është çmimi 28.65€, për m2 . Me datë 16.01.2013 , M.K ka shitë këtë parcelë me sipërfaqe prej 5,471m2, Kompani “ ....., ”, për një çmim prej 405,000€, ky është çmimi prej 74,03€ për m2 .Parcela 1877/9 në Lapnasele, me datë 09.07.2007 , K.B e përfaqësuar nga SH.S ka shitur këtë parcelë me sipërfaqe prej 5,096 m2 , V.SHt për një çmim prej 127.400€, ky është çmimi prej 25 € për m2 . Me datë 30.10.2007, V.SH I ka shitur këtë parcelë S.P për një çmim prej 153.000€, ky është një çmim prej 30.02m2.

Nga shkresat e lëndës Gjykata gjen se rasti V....., toka e familjes V..... ishte parcela numër ..... në ....., me një sipërfaqe prej 21.026 m2. Kjo tokë është marr nga familja nëpërmjet të kontratës të shitblerjes Ov. Nr. 2321/63, me datë 07.09.1963, me KBI “.....”, por ajo parcelë ju kthye familjes me datë 24.06.1992, me vendim të gjykatës P.nr. 1164/90, pas vlerësimit të shkresave të lëndës gjejmë se kontrata e shitblerjes dhe vendimet u riprodhuan dhe ngastrat e tokës ..... është e zëvendësuar me parcelat e tokës ....., në një sipërfaqe prej 22.700 m2 dhe parcela ....., në një sipërfaqe prej 13.654 m2 të cilat që të dyja gjenden në ....., ku të dy kopjet e dokumentit origjinal dhe i falsifikuar gjenden në arkivat e Institucioneve Publike. Dosja origjinale e Gjykatës P.nr. 1164/90, ka ndryshuar duke zëvendësuar dokumenti i cili i referohet parcelës 145, me dokumentin të cilat i referohen parcelat ..... dhe ....., ku pas vlerësimit të shkresave të lëndës dosja e falsifikuar e Gjykatës përmban një raport të rremë të Gjeodezisë i cili nuk ishte urdhëruar gjatë procedurës fillestare duke përmendur parcelat 1877 dhe 1870. Flet autorizimet e anëtareve e familjes V..... të cilët kinse i kishin dhënë autorizimin e tyre SH.S për të vepruar në emër të tyre ishin të falsifikuar në bashkëveprim me Ljubica V.....in dhe u përdoren më vonë nga SH.S dhe H.B për të fituar pronësinë e parcelave të tokës 1870 dhe 1877, në të vërtetë Pavle V..... , Milica V..... , Milosav V..... dhe D.S –V..... tash më ishin të ndjera kur letrat e tyre përkatësisht autorizimet janë vërtetuar në gjykatë në vitin 2009. Me datë 13.11.2008, SH.S e ka dorëzuar vendimin P.nr. 1164/90, si bazë ligjore për transferimin e ngastrave nr. 1870, me një sipërfaqe prej 22.700 m2, parcela nr. 1877 , me një sipërfaqe prej 13.564m2 nga “.....”, tek familja V..... , ku i njëjti nuk paraqiti asnjë autorizim për të vepruar në emër të familjes V....., me datë 18.11.2008, SH.S në vend se ta hedhe poshtë kërkesën e SH.S për shkak se ai nuk kishte të drejtë të paraqes kërkesë të tillë, e pezulloi procedurën për shkak se në përputhje me nenin 17 të Ligjit mbi procedurat Administrative nr. 02/L-28 , përfshirja e AKP-së ishte e nevojshme, duke e ndjekur procedurën e saktë që para ardhësi i tij S.Hnuk e kishte ndjekur në rastin S....., andaj në mars të vitit 2009, kërkoj informacione nga AKP-ja dhe nga Gjykata, ku të njëjtën kohë në mars të viti 2009, SH.S tentoj të sajoi autorizime nga familja V....., me pas me datë 30.03.2009, Lubisha V..... lëshoj një autorizim në favor të SH.S, po ashtu në të njëjtën datë D.S, Blazho V..... dhe Miroslav V..... nënshkruan autorizime në favor të SH.S, pa asnjë dokument të letërnjoftimit personal me praninë e dëshmitareve GJ.L dhe N.P, të cilët me pas do të merrnin njërën nga parcelat e përfshira në aktgjykimin e falsifikuar 1870/16, pasi që Miroslav V..... ka qenë i vdekur që nga data 21.04.1999. Me datë 31.03.2009, në Gjykatën në Vushtrri, me pas ZH.V dhe A.M nënshkruan një autorizim në favor të SH.S, A.M ka qenë e vdekur që nga data 03.02.2001. Me datë 16.04.2009, P.V nënshkruan një autorizim në favor të SH.S, autorizimi është i falsifikuar sepse P.V ka vdekur në vitin 2002. Lidhur me këtë SH.S me datë 02.04.2009, mori një përgjigjeje standard të nënshkruar nga kryetari i Gjykatës Komonale në Prishtinë N.U, e cila e konfirmon ekzistencën e kësaj dhe vendimeve tjera, i përmend palët jo edhe parcelat, ndërsa AKP-ja bëri kërkesë pran Gjykatës Komonale në Prishtinë, dhe siguroj aktgjykimet dhe kontrata e datës 1963, dhe bëri kërkesë NSH “ ....., ”, në Fushë Kosovës dhe mori vendimin autentik dhe kontratën e cila përmend vetëm parcelën 145 në Fushë Kosovë, pas vlerësimit të tyre konstatoj se aktgjykimet dhe kontratat që gjenden në arkivin e Gjykatës janë të falsifikuar. Me

datë 03.07.2009, AKP-ja ka paraqitur një kallëzim penal në prokurorin Komunale, të njëjtën ditë AKP-ja e ka njoftuar Zyrën kadastrale- SH.Sn mbi falsifikimin duke kërkuar se i njëjti të mos marr as një veprim në lidhje me kërkesën e paraqitur nga SH.S, me pas SH.S u detyrua ta vë procedurën në pritje. Me datë 28.08.2009, Prokurori i Prokurorisë Themelor në Prishtinë Faik Hoxha e autorizoj policin e Kosovës që ti kryej hetimet. Me datë 05.11.2008, Policia e Kosovës ka paraqitur një raporte tepër të dobët duke thënë se ata nuk kanë gjetur ndonjë pa rregullsi në kontratën e vitit 1963, që e morën nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. Me datë 15.12.2010, prokurori R.S e ka njoftuar AKP-në se Prokuroria nuk ka gjet se ka pas falsifikim të dokumentit në fjalë, mandej edhe nëse ka pasur vepra penale është parashkuar, megjithatë dosja e lëndës nuk përmban as një aktvendim për pushim të lëshuar nga prokurori në pajtim me neni 208 të KPP-së. SH.S pas disa muaj të shqyrtimit me datë 22.03.2011, vendosi ti nxjerr dy dokumente të ndryshme, e para ishte një letër për AKP-në, ku pyeti AKP-në, nëse pas vendimit të dyshuar të Prokurorisë Komunale, ata ishin duke e vazhduar ndjekjen si paditës substiar dhe nëse ka pasur ndonjë pengesë ligjore që e ndalon regjistrimin e pasurisë së palujshme. AKP-ja nuk i është përgjigjur me shpejtësi. Dokumenti i dytë është një vendim për pezullimin e përkohshëm të procedurës për shkak që kërkuesi SH.S duhej të nënshkruante kërkesën dhe të jep prova se çmimi i përmendur në aktgjykim për kthimin e pronës është i paguar, e cila kërkesë nga dosja e lëndës konstatohet se nuk është përmbushur. Me datë 11.05.2011, SH.S lëshoj Aktvendim me nr.011-052-1-4062, i cili e miratoj kërkesën e SH.S, të datës 13.11.2008, duke e autorizuar transferimin e pronësisë së ngastrës 1870 dhe 1877 nga NSH “Kosova Eksport” te Pavle V..... Me një herë pas kësaj SH.S në emër të shtatë trashëgimtarëve me datë 26.07.20011, ka filluar procesin e transferimi të pronësisë të gjithave parcelave tek anëtarët tjerë të grupit si H.B dhe I.S, ose tek njerëzit shumë të afërte të grupit SH.M dhe A.M, të njëjtit paraqiten kërkesa pran zyrës kadastrale për transferim të pronave, pas disa procedurave me datë 06.03.2012, SH.S aprovoi kërkesën për transferimin e pronës ngastrës 1877 të paraqitu nga H.B, të njëjtën ditë SH.S e informoi SH.Mn se duhet të bëhet ndarja fizike për parcelën nr.1870, për shkak se ajo e bleu nga dy blerës të ndryshëm. Me datë 15.03.2012, SH.S aprovoi kërkesat për transferimin e pronës SH.Mt, A.Mt dhe I.S, duke iu referu parcelave me numër 1870, e cila tani ishte ndarë në parcelat 1870-1 dhe ..... Në shkresat e lëndës gjendet se parcela me numër ..... në ....., me datë 26.07.2011, SH.M, bleu pjesën e mbetur të parcelës të tokës me një sipërfaqe prej 2700m2, nga H.B, ku i njëjti ishte duke vepruar si person i autorizuar në emër të familjes Vujoviq për shkak të transferimit të autorizimit nga SH.S, çmimi i blerjes së parcelës së lartcekur ishte 9.000€, e cila është një çmim prej 3.33 €, m2 . Me datë 28.07.2011, SH.M i dha A.Mt kompetencat e avokatit për të vepruar në emër të saj lidhur me këto parcela të tokës. Me datë 02.07.2012, “ .....,” e përfaqësuar nga drejtori S.B bleu këtë parcelë nga SH.M për një çmim prej 150.000 €, ky është çmimi prej 55.56m2, ku S.B i dha A.Mt kompetencat e avokatit për të vepruar në emër të kompanisë. Parcela 1870 -3 në ..... me datë 30.07.2012, I.S ndau këtë parcelë nën –parcelat 1870-10 dhe ..... Parcela 1870-4 në ....., E.U gruaja e R.U, me datë 02.05.2012 bleu këtë parcelë nga I.S, me një sipërfaqe prej 10.000m2, për një çmim prej 9.500, ky është çmimi 0.95 për m2, me pas E.U ndau parcelën 1870-4 në dy pjesë, e cila u bë 1870-5, me sipërfaqe 7.000 m2 dhe 1870-6, me sipërfaqe 3.000m2. Parcela 1870-5 dhe 1870-6 në ..... më vonë E.U ribashkoj parcelën 1870-5 dhe 1870-6, dhe ndau tersin e kësaj parcele prej 10.000m2 në tri pjesë. Këto pjesë u bënë parcela 1870-7, me sipërfaqe 5.300m2, ....., me sipërfaqe 2.700m2, dhe parcela 1870-9 në sipërfaqen prej 2.000m2. Parcela nr. 1870-7 në ..... me datë 15.08.2012, E.U ndau këtë parcelë nën- parcela 1870-12, 1870-13, dhe 1870-14. Parcela 1870 -8, në ..... me datë 14.08.2012, E.U i shiti këtë parcelë I.B për një çmim prej 9.000€, në sipërfaqe prej 2,700m2, ky është çmim prej 3.33 € për m2. Parcela nr. 1870-10, në ..... me datë 31.10.2012, I.S i dha autorizim J.Gt për të vepruar në emër të tij lidhur me parcelën nr. 1870-10. Me datë 07.11.2012, I.S e ndau këtë parcelë nën parcelat 1870-17, dhe ..... Parcelën ..... në ....., me datë 24.08.2012, I.S i shiti këtë parcelë E.C për



një çmim prej 9.900€, në sipërfaqe prej 4.000m<sup>2</sup>, ky është çmimi prej 2.48 € për m<sup>2</sup>. Parcela nr. 1870-17 në ..... me datë 16.11.2012, I.S ndau këtë parcelë në nën parcelat .....1, dhe .....2. Parcela ..... në ..... me datë 08.01.2013, një marrëveshje është bërë në mes I.S dhe J.Gt që përfaqëson “.....”, për mes të cilës J.G i është dhënë e drejta e pronësisë mbi këtë parcelë. Me datë 04.03.2013, J.G që përfaqëson “.....” i shiti këtë parcelë B.R për një çmim prej 60.000€, për një sipërfaqe prej 1.000 m<sup>2</sup>, ky është çmimi prej 60 €, për m<sup>2</sup>, kjo blerje është paguar nëpërmjet një automjeti “BMW X6” në vend të parave. Parcela .....2 në ..... me datë 16.11.2012, I.S i shiti këtë parcelë SH.L për një çmim prej 60.000€, në sipërfaqe prej 1.540m<sup>2</sup>, ky është çmimi prej 38.96 € për m<sup>2</sup>. Me datë 25.06.2013, SH.Li shiti këtë parcelë E.C për një çmim prej 61.000 €, ky është çmimi prej 39.61 €, për m<sup>2</sup>. Me 07.05.2015, E.C i shiti këtë parcelë J.L dhe A.H për një çmim prej 72.000€, ky është çmimi prej 46.75 €, për m<sup>2</sup>. Gjykata konstaton se e gjithë kjo e cekur më lartë është kronologjia e bartjes së pronësisë dhe e shitë-blejjes së parcelave që janë objekti i shqyrtimit në këtë çështje penale.

Nga provat mbi të cilat është bazuar aktakuza, rezulton një përshkrim i përgjithshëm i pikave të dispozitivit të kësaj aktakuze duke mos e specifikuar përshkrimin faktik të dispozitivit të aktit akuzues për secilin të akuzuar veç e veç, por vetëm duke u thirrur në çmimin më të lirë me rastin e shitblerjes së paluajtshmërive që janë objekt akuze, me arsyetimin hipotetik, se në një të ardhme “zonat ku gjenden pasuritë i janë nënshtruar një zhvillimi komercial... nuk janë duke u përdorur për qëllime bujqësore... dhe kërkesat e investitorëve janë duke u rritur kryesisht nga kërkesa për ndërtime banimi dhe komerciale”. Ndërkaq, nga arsyetimi i pikave të dispozitivit të kësaj aktakuze lidhur me shitblerjen e këtyre paluajtshmërive, nuk është prezantuar ekzistimi i asnjë fakti, apo prezantimi i ndonjë prove relevante që do ta vërtetonte ndonjë rrethanë, në bazë të së cilës, objektivisht do të krijohej dyshim i bazuar mirë, se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Të gjithë këta të akuzuar akuzohen se paluajtshmëritë kontestuese i kanë blerë me një çmim më të lirë se çmimi i tregut, dhe bazueshmëria e çmimit të tregut është ndërtuar mbi bazën e mendimit të ekspertëve ndërkombëtar, sipas të cilës çmimi minimal për periudhën kohore 2010-2015, në atë rajon, për shitblerjen e tokave bujqësore ka qenë prej 15 euro për metër katror.

Kryetarja e trupit gjykues duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar faktin se gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, Drejtoria e hetimeve për krime ekonomike nga Policia e Kosovës, me datë 17.03.2015, i është drejtuar me një kërkesë Zyrës së Drejtorisë së Kadastrit në Prishtinë, nga e cila ka kërkuar që kësaj Drejtorie t’i dorëzohen kopjet e kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive për regjionin e Qagllavicës, dhe atë vendi i quajtur Mirkovica, Mirkovica Mali Breg, Mirkovica Veliki Breg, Mirkovica Breg, Mirkovica Do Puta, Mirkovica Milina, Mirkovica Potik, Kunovaci dhe ....., për periudhën 2010-2014. Dhe Drejtoria për Kadastër, i është përgjigjur kërkesës së Policisë së Kosovës, duke ia bashkangjitur një numër të kontratave të cilat variojnë me çmime të ndryshme, dhe atë :

- kontratën e datës 27.12.2012, me nr. të certifikatës UL-73414058-00170, me nr. të parcelës P-73414058-00490-30, në zonën kadastrale Preoc, zonë rurale më sipërfaqe 0.93,60 ha, është shitur me çmim prej 33,000.00 euro, çka do të thotë se është paguar çmimi për ari dikund rreth 400 euro, apo 4 euro për metër katror ;
- kontratën e noterizuar e datës 28.04.2014, me nr. të certifikatës 1179-2014, me nr. të parcelës P-73414058-00009-3, në Zonën Kadastrale Preoc, tokë bujqësore klasa e 4-të, me sipërfaqe prej 522 m<sup>2</sup>, është shitur me çmim prej 9,500.00 euro, që do të thotë me çmim për ari më pak se 2,000.00 euro për metër katror, apo 20 euro për metër katror ;
- kontratën e noterizuar e datës 29.08.2012, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., po ashtu në Zonën Kadastrale në ....., tokë bujqësore, me sipërfaqe prej 5128

metra katrorë, është shitur me çmimin prej 9,500.00 euro, pra më pak se 2,000.00 euro për metër katror apo më pak se 20 euro për metër katror ;

- kontratën e datës 05.12.2012, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në Zonën Kadastrale ..... të komunës së ....., sipërfaqja prej 0.34,43 ha është shitur në shumën prej 7,230.00 euro, me një çmim prej rreth 220.00 euro për ari për metër katror apo rreth 2.20 euro për metër katror;

- kontratën e shitblerjes e datës 29.12.2009, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale në Qagllavicë, tokë bujqësore, paluajtshmëria me sipërfaqe prej 860 metra katror, është shitur me çmimin prej 7,500.00 euro, që do të thotë diku rreth 900 euro për ari, apo 9 euro për metër katror ;

- kontratën e datës 14.01.2013, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale të Graqanicës, me sipërfaqe prej 4615 metra katror, është shitur me çmimin prej 9,200.00 euro, që i bie dikund rreth 200 euro për ari, apo 2 euro për metër katror ;

- kontratën e datës 06.01.2010, me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale Qagllavicë, tokë bujqësore, me sipërfaqe prej 2655 metra katror, është shitur me çmimin prej 118,678.50 euro që do të thotë dikund rreth 4700-4800 euro për ari, apo 47 euro për metër katror ;

- kontratën e cila nuk ka datë të përpilimit, që bëhet fjalë për paluajtshmërinë me nr. të certifikatës UL-....., me nr. të parcelës P-....., në zonën kadastrale të Qagllavicës, tokë bujqësore, klasa e 4-të, me sipërfaqe prej 1000 metra katror, është shitur me çmimin prej 9700 euro, që i bie rreth 970 euro për ari, apo më pak se 10 euro për metër katror.

Ndërkaq, nga të dhënat si në aktakuzë, rezulton se tani të akuzuarit nga B.A, deri te i akuzuari A.H, paluajtshmëritë që janë objekt akuze, i kanë blerë me një çmim shumë më të lartë, se çmimi i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive në këto kontrata.

Prokurori i çështjes me rastin e vlerësimit të çmimit të shitjes se tokave bujqësore, nuk i ka vlerësuar fare këto prova, edhe pse është dashur dhe ka pas për detyrë t'i vlerësojë si provat fajësuese ashtu edhe provat shfajësuese për të dyshuarit, konform dispozitave ligjore nga neni 7 i KPPRK-së. Dhe në qoftëse vlerësohen çmimet e këtyre kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive të prezantuara nga Drejtoria për Kadastër në Komunën e Prishtinës, vërtetohet fakti se këtu në këto kontrata, kemi të bëjmë me zona përafërsisht të njëjta kadastrale, me periudha të përafërta kohore të shitblerjes, kur është bërë dhe shitblerja e paluajshmërive që janë objekt i akuzës, dhe një pjesë bukur e madhe e kontratave të paluajshmërive të prezantuara nga zyra e kadastrit, rezulton të jenë shitblerje me çmime më të ulëta a të përafërta, me çmimin që e kanë paguar të gjithë të akuzuarit që akuzohen për blerjen e paluajtshmërive në aktakuzë, duke filluar nga i akuzuari B.A, deri te i akuzuari A.H. Pra, nga këto prova materiale, nuk vërtetohet fakti se çmimi i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive që janë objekt akuze, paska pas qenë më i ultë se çmimi i tregut për atë periudhë kohore.

Fakt tjetër relevant në këtë çështje penale që krijon besueshmëri të një shkalle relativisht të lartë për gjykatën, se i akuzuari B.A, deri te i akuzuari A.H, nuk kanë qenë në dijeni apo nuk kanë mund të jenë në dijeni për mënyrën e dyshimtë të fitimit të pronësisë nga të akuzuarit në pjesën toka 1, si SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, është edhe regjistrimi i këtyre paluajshmërive në regjistrat kadastral të Komunave përkatëse. Për krejt këto paluajshmëri, bartja e të drejtave pronësore nga këndvështrimi formal, është bërë konform dispozitave ligjore, çka do të thotë se për këto paluajshmëri janë lidhur kontrata formale, në formë të shkruar, të noterizuara, të dëshmuara për transaksionet bankare përkatësisht transferimit të mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare, nuk ka pas asnjë ndalesë apo pengesë ligjore për shitblerjen e këtyre pronave, nga të gjitha këto veprime nuk vërtetohet dyshimi i bazuar i ekzistimit të një qëllimi

tjetër për ta ndihmuar dikend, ashtu që, të gjitha këto rrethana krijojnë nëse jo bindshmëri, besueshmëri të shkallës së lartë, se këto paluajtshmëri janë regjistruar në regjistrat kadastral, konform dispozitave ligjore në fuqi.

Po ashtu, në rastin konkret këto paluajtshmëri kanë qenë të bartura tek pronaret, duke u bazuar në vendime gjyqësor që ka formën e prerë dhe në bazë të atyre vendimeve gjyqësor janë regjistruar paluajtshmëria në regjistrat kadastral në komunat përkatëse, atëherë një gjendje e tillë e fakteve në asnjë mënyrë nuk mund të lenë vend për dyshim, se fitimi i të drejtës së pronësisë, është bërë në mënyrë të kundërligjshme, në të kundërtën, nëse do viheshin në dyshim çdo herë vendimet gjyqësore dhe regjistrat kadastral paraprakisht, do të vëhej në pikëpyetje edhe vet funksionimi i organeve shtetërore në përgjithësi, duke mos e përjashtuar faktin se mund të ketë vendim të kundërligjshëm gjyqësor, por në rastin konkret, askush nga palët me interes juridik, nuk i ka kontestuar vendimet gjyqësor me mjete të rregullta juridike, vendimet janë bërë të formës së prerë, dhe nuk është vendosur asnjë masë e përkohshme për ndalimin e bartjes së të drejtës së pronësisë për këto paluajtshmëri. Dhe bazuar në këto vendime gjyqësor edhe janë regjistruar të drejtat e pronësisë në regjistrat kadastral, dhe është fakt notor se regjistrat kadastral janë libra publike, dhe çdo palë e interesuar ka të drejtë të informohet se kush është titullar i asaj paluajtshmërie, dhe me vet faktin e këtij regjistrimi, e drejta e pronësisë së pronarit të caktuar supozohet se është e drejtë dhe e ligjshme, derisa mos të vërtetohet e kundërta.

Po ashtu, prokuroria nuk ia ka bashkangjitur shkresave të lëndës ndonjë provë konkrete që do rezultonte me krijimin e dyshimit të bazuar se të akuzuarit, duke filluar nga B.A, deri te i akuzuari A.H, kanë mund të kenë dijeni se kjo pasuri është fituar në mënyrë të kundërligjshme. Dhe nëse do të ishte kështu, pra sipas prokurorisë bazuar në kriterin e çmimit të shitblerjes së paluajtshmërive, do të ekzistonte përgjegjësi penale në radhë të parë për të gjithë noterët që kanë përpiluar dhe vërtetuar kontrata të tilla, dhe për të gjithë personat zyrtar që punojnë në drejtorinë kadastrale, e të cilët ua kanë mundësuar atyre personave regjistrimin e paluajtshmërive në pronësitë e tyre në regjistrat kadastral, kjo për faktin se të njëjtit kanë për detyrë si persona zyrtar, t'i lajmërojnë këto raste të dyshimta të transaksioneve pronësore te organet e ndjekjes, nga se të njëjtit, nga praktika dhe përvoja e punës, kanë njohuri më shumë se të gjithë blerësit e paluajtshmërive lidhur me çmimet e shitblerjeve të paluajtshmërive, për shkak se të njëjtëve iu dorëzohen po thuajse për çdo ditë shkresat e lëndës dhe kontratat e shitblerjes me rastin e bartjes dhe regjistrimit të pronësisë nga një pronar në tjetrin. Por pse nuk ka ndodhur kjo, dhe mirë që nuk ka ndodhur, sepse Gjykata vlerëson se kjo nuk ka ndodhë dhe nuk mund të ndodhë për faktin se siç shihet nga kopjet e kontratave të shitblerjes së këtyre pronave, në këto zona të përafërta të kategorizuara si toka bujqësore, nga klasa e 3 deri 6, këto paluajtshmëri janë shitblerë me çmime shumë të ndryshme, e që kjo vërteton bazën e shprehjes së vullnetit të lirë dhe të plotë të palëve kontraktuese me rastin e lidhjes së një kontrate, se çdo person disponon në bazë të vullnetit të plotë të tij, me pasurinë përkatësisht paluajtshmerinë e tij, dhe vlerën e qarkullimit të paluajtshmerisë e përcakton vlera e tregut, përkatësisht oferta dhe kërkesa. Dhe Gjykata e vlerëson të besueshëm çmimin e këtyre kontratave, nga se me vet faktin se në bazë të këtyre kontratave është bërë bartja e pronësisë, rezulton se për të gjitha ato kontrata të dorëzuara nga regjistrat kadastral, nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë apo ankese nga cilado palë, dhe se nuk është kontestuar nga askush shitblerja e këtyre paluajtshmerive, nga asnjë bazë e mundshme ligjore.

Gjithashtu gjykata vlerëson se nuk është detyrë e blerësve për ta vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pronës, nga se kjo vërtetohet përmes institucioneve relevante të sistemit juridik të një shteti, dhe atë në radhë të parë duke filluar nga të dhënat kadastrale ku janë të regjistruar pronarët e paluajtshmerive, dhe këto regjistra janë regjistra publik, quhen publik pikërisht për faktin se të gjithë qytetarët që kanë interes për ta ditur se kujt i përket një paluajtshmëri, kanë qasje në këto

regjistra dhe mund ta dinë se kush është pronar i asaj prone, dhe vetëm ekzistimi i këtij fakti është rrethanë e mjaftueshme për të besuar dhe mos dyshuar se origjina e pasurisë buron nga krimi, kjo edhe për faktin se regjistrimit të paluajtshmërisë në regjistrat kadastral, i paraprijnë një sërë veprimesh tjera të cilat duhet ndërmarrë konform dispozitave ligjore, për të ardhur deri te veprimi final, pra regjistrimi i paluajtshmërisë, e që ato veprime janë ekzistimi i një kontrate të shitblerjes mes palëve që supozon pajtimin e plotë të vullnetit të palëve për të gjitha kushtet e shitblerjes, vërtetimi i asaj kontrate te noteri, i cili është i autorizuar të vlerësoj lidhjen e kontratës juridikisht të vlefshme edhe sipas detyrës zyrtare, realizimi i pagesave dhe transaksioneve përmes bankës dhe dëshmitë për këto transaksione, mos ekzistimi i ndonjë barre, ndalese a hipoteke, apo ndonjë mase të përkohshme të sigurisë për ndalimin e bartjes së të drejtës së pronësisë personit tjetër, a pretendim tjetër që ndalon bartjen e pronësisë për ato paluajtshmeri, apo baza tjetër e fitimit të së drejtës së pronësisë, e që është ekzistimi i ndonjë vendimi gjyqësor për fitimin e të drejtës së pronësisë, e i cili do të shërbej si bazë ligjore për ta regjistruar atë paluajtshmeri në emër të titullarit-pronarit të saj. Ashtu që, ekzistimi i cilës apo të gjitha këtyre rrethanave të lartëcekura, objektivisht e përjashtojnë dijeninë e palës me interes juridik, se në ato paluajtshmeri, ka diç kontestuese a kundërligjore.

Po ashtu, shkresave të lëndës prokuroria nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë tjetër për të krijuar dyshim të bazuar se blerësit e këtyre paluajtshmerive, tani të akuzuarit nga B.A, deri te i akuzuari A.H, të kenë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës, përmes të cilave prova, do të rezultonte dyshimi eventual i bazuar, se këta të akuzuar kanë ditur, apo kanë mund të ishin në dijeni, se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral e fletet poseduese nga të akuzuarit SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme, për kryerjen e aktiviteteve kriminale, apo se ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin e parave.

Gjykata duke e vlerësuar dhe analizuar pretendimin e Prokurorit të çështjes, se paluajtshmeritë janë shitur me çmim më të ulët se çmimi i tregut, mirëpo nuk ka prova mbështetëse për ta krijuar dyshimin, se përveç interesit ekonomik të të akuzuarve për të përfituar personalisht, nuk mund të vërehet ndonjë motiv tjetër, a ndihmë eventuale për të akuzuarit tjerë në pjesën toka 1, e kur kësaj i shtohet edhe fakti se në disa raste edhe këto paluajtshmeri, nuk janë shitur drejtpërsëdrejti nga tani të akuzuarit SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, tek të gjithë të akuzuarit në këtë çështje penale, pasi që të akuzuarit B.A, XH.B, M.K, V.SH, J.G, SH.L, E.C kanë bërë blerjen e palujshmerive nga të akuzuarit në pjesën toka 1, dhe ju kanë shitë të njëjtat palujshmeri të akuzuarve H.Ht, N.SH, kompanisë “ ..”, S.P, B.R, E.C, J.L dhe A.H, ashtu që bazuar në të gjitha këto rrethana të cekura më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se të akuzuarit duke filluar nga i akuzuari B.A, deri te i akuzuari A.H, ka qenë e pamundur për ta ditur apo për të dyshuar se këto paluajtshmeri janë produkt i një vepre penale.

Po ashtu, vështruar nga këndi tjetër, duke u nisur nga fakti jo kontestues se të gjithë blerësit nuk e kanë ditur bazën apo historiatin e fitimit të pronësisë, dhe nëse është kështu, pra, cilat janë ato prova në shkresat e lëndës që e vërtetojnë rrethanën relevante kryesore, se blerësit kanë qenë në dijeni apo mund të kenë qenë në dijeni, se pronësia është fituar nga aktiviteti kriminal i të akuzuarve SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, kur dihet paraprakisht fakti se pronësia është fituar në bazë të vendimeve gjyqësor të formës së prerë, dhe titullari është i regjistruar si pronar në regjistrat kadastral, dhe Kryetarja e trupit gjykues, ka konstatuar se në shkresat e lëndës, nuk ekziston ndonjë provë që e dëshmon dhe provon ekzistimin e kësaj rrethane, pra se blerësit kanë ditur apo kanë qenë të detyruar apo kanë mundur ta dinë se vendimet gjyqësor përmes të së cilit është bërë regjistrimi i të drejtës së pronësisë në regjistrat kadastral, dyshohen se janë përcjellë me veprime të aktiviteteve kriminale.

Po ashtu, të akuzuarit B.A, deri te i akuzuari A.H, akuzohen se i kanë ndihmë të akuzuarit SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S në shpërlarjen e parave, për vërtetimin e këtij pretendimi, prokuroria nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë konkrete që do vërtetonte dyshimin për një pretendim të tillë, duke mos përshkruar rrethanat se si i kanë ndihmua, në ç'mënyrë i kanë ndihmua të akuzuarve të lartcekur, cili ishte motivi për t'i ndihmë të njëjtit. Edhe nën supozimin se çmimi i blerjes ishte i ulët, rrjedhë pyetja se pse i kanë blerë dhe cila ishte arsyeja e blerjes së këtyre pronave, a i ndihmuan vetes apo të akuzuarve SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, kur dihet fakti se është bërë bartja e të drejtës së pronësisë nga njëri te tjetri, se këto prona iu janë bartur në pronësi edhe personave të tretë tek të akuzuarit H.Ht, N.SH, kompanisë “ .....”, S.P, B.R, E.C, J.L dhe A.H, a patën shpërblim të akuzuarit tjerë nga të akuzuarit SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S për një ‘ndihmesë’ të tillë, dhe nëse po, çfarë ishte ajo ndihmesë, a kishte lidhje a marrëveshje paraprake mes të njëjtëve, si u njohën në mes veti, cila ishte bindja e prokurorisë dhe në çka bazohet kur pretendon se nga rrethanat objektive do duhej ta dinin se pronësia ishte fituar me aktivitet kriminal, e shumë pyetje e dilema tjera, që duhej vërtetuar nga gjykata, e që prokuroria në këtë fazë të procedurës penale, do duhej t'ia bashkangjiste provat kësaj aktakuze, për ta vërtetuar së paku ekzistimin e një dyshimi të bazuar të kryerjes së kësaj veprë penale nga të akuzuarit B.A, deri te i akuzuari A.H, dhe për ta detyruar gjykatën që të vazhdoj me fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Andaj, konstatimi i prokurorit bazuar në arsyetimin se sipas vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtar “parcelat e tokës gjendeshin në zonën bujqësore në shtator të vitit 2010... zonat ku gjenden pasuritë i janë nënshtruar një zhvillimi komercial... nuk janë duke u përdorur për qëllime bujqësore... dhe kërkesat e investitorëve janë duke u rritur kryesisht nga kërkesa për ndërtime banimi dhe komerciale”, një konstatim i tillë në të drejtën penale nuk qëndron dhe nuk mund të ekzistojë, kjo për faktin se ngjarjet e ardhshme të pasigurta mund të jenë rrethana relevante për modifikimin e punëve juridike në të drejtën civile, por jo për të përcaktuar përgjegjësinë penale në të drejtën penale. Gjithashtu duhet kuptuar dhe interpretuar drejtë rolin dhe cilësinë e shtetit a organeve shtetërore a ndërmarrjeve shoqërore në procedurë civile dhe raportet juridiko civile, e që janë dhe duhet të jenë plotësisht të barabartë me qytetarët si palë në procedurë, dhe se nën kushtet e respektimit të dispozitave ligjore, edhe prona shoqërore mund të transferohet në pronësi private, por assesi jo në mënyrë të kundërligjshme.

Gjykata po ashtu e vlerëson të rëndësishme t'i referohet pretendimeve të mbrojtjes së të akuzuarve nga B.A, deri te i akuzuari A.H, nga të cilat deklarata krijohet një shkallë e lartë besueshmërie se vërtetë të njëjtit nuk e kanë ditur, dhe në rrethanat në të cilat kanë vepruar nuk kanë mund të dinë për mënyrën se si janë bërë titullar të këtyre paluajtshmërive të akuzuarit SH.S, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, ku kanë shpjeguar mënyrën se si kanë ardhur në kontakt me tani këta të akuzuar, po ashtu në këtë çështje penale gjykata gjen se shitja dhe blerja e parcelave të tokave të lartcekura është bërë edhe në mes të palës së tretë, të akuzuarve si në vijim: i akuzuari B.A parcelën e tokës ....., të blerë nga E.G, ja shet të akuzuarit H.Ht, i akuzuari XH.B parcelën e tokës 1877/1, të blerë nga SH.S si përfaqësues dhe në emër K.B, ja shet të akuzuarit N.SH, i akuzuari M.K parcelën e tokës 1877/2, të blerë nga SH.S si përfaqësues dhe në emër K.B, ja shet kompanisë “ .....”, i akuzuari V.SH parcelën e tokës 1877/9, të blerë nga SH.S si përfaqësues dhe në emër K.B, ja shet të akuzuarit S.P, i akuzuari J.G parcelën e tokës 1870/18, të marr me marrëveshje nga I.S, ja shet të akuzuarit B.R, i akuzuari SH.L parcelën e tokës 1870/22, të blerë nga I.S, ja shet të akuzuarit E.C, i akuzuari E.C parcelën e tokës 1870/22, të blerë nga akuzuari SH.L, ja shet të akuzuarve J.L dhe A.H, po ashtu se cili ka shpjeguar arsyet për blerjen e atyre paluajtshmërive, të cilat nuk lënë hapësirë për të krijuar dyshim se vërtetë këta të akuzuar në çfarëdo mënyre e kanë ditur apo kanë mund të jenë në dijeni se si është bërë titullar i paluajtshmërive fillimisht, pra këta të akuzuar në deklaratat e tyre në

mënyrë logjike dhe të kuptueshme kanë shpjeguar prejardhjen e të hollave me të cilat kanë blerë këto paluajtshmëri, që kryesisht kanë qenë hua të siguruara nga familjar a miq të ndryshëm, apo nga bankat komerciale, pastaj kursimet e siguruar ndërvite përfshirë edhe nga puna në botën e jashtme, të ardhura të gjeneruara nga biznese që kanë në pronësi apo nga shitja e paluajtshmërive tjera që kanë pasur në pronësi, pastaj mënyrën e kontaktit për blerjen e tokës apo kanë dëgjuar se të njëjtit ishin duke shitur tokë, siç është rasti me të akuzuarin I.B, A.H, apo përmes miqëve të tyre, siç është rasti me të akuzuarin A.H është njoftuar nga daja i tij i akuzuari J.L, B.R nga shoku i vjetër tij i akuzuari J.G, të akuzuarit B.A,N.SH , M.K, H.H janë njoftua për shitjen e tokës ku e ka pa shpalljen në rrugë me një numër të telefonit, kanë ardhur në dijeni për mundësinë e blerjes së këtyre paluajtshmërive dhe të joshurë nga çmimi, të akuzuarit B.A, A.H, H.H, N.SH, XH.B dhe V.SH kishte blerë palujshmeri me qëllim të zhvillimit të biznesit, kanë vendosur blerjen e tyre, pastaj arsyeshëm kanë shpjeguar motivet pse i kanë blerë ato paluajtshmëri, e që ka qenë qoftë ndërtimi i objekteve të caktuara për banim siç është rasti me të akuzuarin A.H, qoftë se paluajtshmëritë në fjalë kanë qenë afër vendeve të kenë banuar apo ushtruar biznes dhe kanë dashur ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre duke i blerë paluajtshmëritë në fqinjësi, siç është rasti me të akuzuarin S.B, SH.L për ndërtimin e objektit banesor apo të akuzuarin J.G, i cili është marrë me biznesin e shitjes së paluajtshmërive, dhe nisur nga çmimi, kanë blerë paluajtshmëritë me qëllim që të njëjtat t'i shesin me një çmim më të lartë, i akuzuari J.L ka blerë token pa një plan konkret por vetëm si investim në të ardhmen, e që është e pritshme dhe e kuptueshme, pra qëllimi i përfitimit material. Po ashtu gjithë këta të akuzuar, i janë referuar faktit se titullar i paluajtshmërive kanë figuruar, e kanë blerë nga i njëjti, dhe se për këto paluajtshmëri ka pasur vendime të gjykatës të cilat kanë qenë të formës së prerë, dhe si të tillë, nuk kanë pasur arsye me dyshue për mënyrën e paligjshme të vënies nën pronësi të këtyre paluajtshmërive dhe në këtë drejtim është e rëndësishme të theksohet fakti se asnjëri nga këta të akuzuar nuk kanë pasur dijeni për aktivitetin kriminal, e që do mund të përbënte ndonjë element për të dyshuar për mënyrën e paligjshme të bërjes së tyre titullar të atyre paluajtshmërive, ndërsa që siç u tha edhe më lartë, pretendimi i prokurorit se këta të akuzuar është dashur të dijnë se prona shoqërore nuk mund të transferohet te një qytetar privat, përveç nëse ka qenë pronar orgjinal i aseteve apo në proces të privatizimit, është i pabazuar për faktin e thjeshtë se jo vetëm këta të akuzuar që nuk kanë mund ta dijnë rrethanën e të vepruarit kundërligjshëm, por këto rrethana të dyshuara si të kundërligjshme, nuk i kanë ditur as personat tjerë zyrtar, të cilët kanë pasur mundësi më të mëdha për t'i ditur këtë rrethana, pra personat të cilët i kanë regjistruar këto paluajtshmëri fillimisht në emër të akuzuarve SH.S si përfaqësues dhe në emër K.B, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, të cilit edhe i kanë lëshuar fletët poseduese, në të cilat këta të akuzuar figurojnë si titullar të këtyre paluajtshmerive, e që kjo rrethanë ka qenë vendimtare në vendosmërinë e këtyre të akuzuarve për të blerë paluajtshmëritë nga të njëjtit, andaj gjykata vlerëson se me asnjë provë nuk vërtetohet për të krijuar dyshim të bazuar se blerësit e këtyre paluajtshmërive, tani të akuzuarit nga B.A, deri te i akuzuari A.H, të kenë pasur çfarëdo lidhje subjektive me të akuzuarit e pjesës tjetër të aktakuzës, përmes të cilave prova do të rezultonte dyshimi eventual i bazuar, se këta të akuzuar kanë ditur, apo kanë mund të ishin në dijeni, se vendimi gjyqësor, regjistri kadastral e fletet poseduese të të akuzuarve SH.S si përfaqësues dhe në emër K.B, F.G, E.G, SH.M, E.U dhe I.S, ishin siguruar në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që duke i ditur këto veprime, të njëjtit i kanë ndihmuar të akuzuarve të lartcekur për kryerjen e aktiviteteve kriminale, apo se ka ekzistuar ndonjë marrëveshje paraprake për pastrimin e parave.

Andaj, bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, Kryetarja e trupit gjykues, ka vlerësuar se nga këto dëshmi dhe prova materiale të cilat prokuroria i'a ka bashkëngjitur shkresave të lëndës, nuk mund të rezultojë ekzistimi i dyshimit të bazuar mirë, se të akuzuarit B.A, H.H, A.H, V.SH, S.P, M.K, XH.B, N.SH, S.B, I.B, S.H, SH.L, E.C, J.G, B.R, J.L dhe A.H, e kanë kryer veprën penale secili veç e veç Shpëlarje e parave (vepra penale në bashkim dhe vazhdimësi) në bashkëkryerje

në kundërshtim me nenin 23 dhe 71 të KPK-së, në fuqi deri me datë 31.12.2012, po ashtu e paraparë edhe në nenet 31 dhe 81 të Kodit të ri Penal të Kosovës në fuqi prej 01.01.2013, në kundërshtim me nenin 10 (2) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/2 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të përfaqëta”, po ashtu në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në fuqi prej 30 shtator 2010, po ashtu e paraparë me nenin 56(1) të ligjit nr. 05/L-096”, Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit “ në fuqi prej 15 qershor 2016, siç referohet në nenin 308 të KPK-së, në fuqi prej 1 Janar 2013, ashtu që, në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 253 par. 1 pika 1.4 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi lidhur me anulimin pjesërisht të urdhërësës për ndalimin e transformimit të të drejtës së pronësisë për paluajtshmëritë e të akuzuarve, me që tani ka pushue procedura penale kundër të akuzuarve si në hyrje të këtij aktvendimi, është marrë konform nenit 116 të KPPRK-së.

Lidhur me arsyet e cekura më lartë, konform nenit 253 par.1, pika 1.4 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti Special**  
**PS.nr.27/19,të date 22.07.2021**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
**Shpresa Sahiti**

**Kryetarja e Trupit Gjykes-Gjyqtarja**  
**Violeta Namani-Hajra**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

**Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 5 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, e nëpërmes kësaj Gjykate.**